

Nr. 55/21 Prot.

Tiranë më 11.07.2024

V E N D I M

Nr. 35 Datë 11.07.2024

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Suela Bulku **Kryesuese**
Arben Sefaj **Relator**
Denisa Sina **Anëtare**

Në datën 04.07.2024, në Godinën e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, kati 1, asistuar nga anëtarja e sekretariatit teknik Znj. Lediana Azemaj, zhvilloi seancën dëgjimore publike për çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT:

Z. Gentjan Agron Shehaj, me funksion Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave edhe Koordinimit, dhe Sigurimit të Cilësisë, në Akademinë e Policisë.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji Nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

Rregullore nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar”.

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi dëgjoi gjetjet bazuar në arsyetimin ligjor si dhe rekomandimin e relatorit të çështjes z. Arben Sefaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit Z. Gentjan Agron Shehaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikën 1, të nenit 4, të Ligjit Nr.12/2018, i ndryshuar.

VËREN:

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Sipas përcaktimeve të neneve 2, 4 dhe 6 të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Z. Gentjan Shehaj është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave edhe Koordinimit, dhe Sigurimit të Cilësisë , në Akademinë e Policisë.
2. Subjekti i vlerësimit, Z. Gentjan Shehaj iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar 04.07.2023 nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
3. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 1 datë 13.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: Znj. Suela Bulku Kryesuese, Z. Arben Sefaj Relator dhe Znj. Denisa Sina Anëtare.
4. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr.1 datë 13.07.2023 vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Gentjan Shehaj.
5. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 14.07.2023 ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
6. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore me e-mailin zyrtar të datë 17.07.2023 duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
8. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
9. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në nenin 4, të Ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar ka për objekt:

- Vlerësimin e pasurisë.
- Kontrollin e figurës.
- Vlerësimin e aftësive profesionale.

10. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligji Nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b. Ligji nr.128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c. Ligji nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d. Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.
- e. Ligji nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- f. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.7, datë 17.01.2023, “Për procedurat e hedhjes së shortit”.
- g. Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.
- h. Duke verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht deklaratat e dorëzuara nga vetë subjekti i vlerësimit në DPPSH që janë:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- *Formulari i Aftësive Profesionale,*
- *Dokumentacioni bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet.*

- i. Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.
- j. Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.
- k. Ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.

11. Trupa e Vlerësimit, me datë 14.06.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Gentjan Shehaj, me Vendimin Nr.2 datë 14.06.2024, vendosi;

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Gentjan Shehaj.
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht,*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional.*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa Vlerësuese, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme prej 5 ditësh për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

12. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 11, neni 5 i Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, si dhe nenit 34, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit Gentjan Shehaj , u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative. Subjekti i vlerësimit nuk kishte zgjedhur mbrojtës ligjor. Gjatë seancës dëgjimore, pas fjalës së relatorit, subjekti i vlerësimit parashtroi disa shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e vlerësimit në tërësi të kryer ndaj tij (të regjistruar në materialin audio në seancë dëgjimore). Në fund të seancës dëgjimore datë 04.07.2024, subjekti i vlerësimit Gentjan Shehaj kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupa e Vlerësimit shpalli vendimin më datën 11.07.2024, për subjektin e vlerësimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

14. Z. Gentjan Shehaj ka qenë korrekt dhe bashkëpunues gjatë procesit të vlerësimit, duke u përgjigjur brenda afatit të përcaktuar, sipas pikës 2, të nenit 48, të ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

15. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, “Vlerësimi i pasurisë”, dhe veçanërisht në nenin 31 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
16. Në zbatim të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Gentjan Shehaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 17.02.2023, kjo sipas vërtetimit të sektorit të burimeve njerëzore të Akademisë së Sigurisë. Formulari i Pasurisë ka nr. ***, index 2023.
18. Procedurat e deklarimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
19. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në të gjitha institucionet apo personat juridike, publikë apo privatë.
20. Gjithashtu Trupa e Vlerësimit ka mbajtur në konsideratë deklarinimet e dhëna nga subjekti për vërtetimet e të ardhurave për secilin vit kalendarik, të shoqëruara me dokumentacion zyrtar, raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare. Ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, pagimin e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
21. Bazuar në nenin 32, pika 1.1, të ligjit nr. 12/2018 ”Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme

dhe Ankesat”, i ndryshuar, “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nga viti 2008 dhe në vijim”.

Neni 1 citon; “Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë”.

Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur,
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI,
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr.12/2018, i ndryshuar,
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaratimet e subjektit, si edhe përgjigjet e pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

22. Hetimi administrativ konsistoi në:

- ✓ Verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- ✓ Verifikimin e burimit/eve të krijimit të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- ✓ Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- ✓ Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

Gentjan Shehaj është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI në vitin 2012, me numër indeksi *** dhe sipas deklarimit online me numër indeksi ***. Në zbatim të ligjit Nr. 9049 datë 10.04.2003 i ndryshuar dhe ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, dhe përveç këtyre bazuar në ligjin nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar, ka plotësuar edhe deklaratën e pasurisë për vlerësimin kalimtar me datë 17.02.2023.

- Para fillimit të detyrës 2012
- Periodike/Vjetore 2012
- Pas largimit nga funksioni 2013
- Para fillimit të detyrës 2015
- Periodike/Vjetore 2015
- Pas largimit nga funksioni 2016
- Para fillimit të detyrës 2017
- Periodike/Vjetore 2017
- Periodike/Vjetore 2018
- Periodike/Vjetore 2019
- Periodike/Vjetore 2020
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022

23. Përveç sa më sipër, bazuar në ligjin nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, në dt. 02.08.2023 ka mbërritur në ILDKPKI.
24. Për kryerjen e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Gentjan Shehaj, ILDKPKI ka krahasuar Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe dokumentacionin justifikues bankar, jo bankar, etj. të dorëzuar nga vetë subjekti, deklaratat e interesave private ndër vite, me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës me nr. *** prot., dt. 03.08.2023.
25. Kontrolli i plotë kryhet për periudhën deri në datën e dorëzimit të Deklaratës së Pasurisë. Për vlerësimin kalimtar, që përfshin këtë deklaratë dhe deklaratat e interesave privatë ndër vite. Bazuar në nenin 32, pika 1.1 të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të kenë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive në rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nga viti 2008 dhe në vijim". Neni 1 citon: "Subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të deklarojnë çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar, nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë".
26. Në zbatim të ligjit nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiarë të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, të ligjit nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

27. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, në nenin 33/1, të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, bazuar në dokumentacionin e administruar, ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 19.01.2027, "Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë për vlerësimin kalimtar të subjektit Gentjan Shehaj", protokolluar me tonën nr. *** prot., datë 07.02.2024 konstatohet se:
 - a. deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare,
 - b. nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë,
 - c. nuk është kryer fshehje e pasurisë,
 - d. nuk është kryer deklarim i rremë,
 - e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Në deklaratën e pasurisë për Vlerësimin Kalimtar është deklaruar:

DEKLARIMI 1 PASURIVE

28. 1. Apartament me sipërfaqe totale 85.70 m², nr. ***, zk. 3866, vol. ***, fq. ***, e regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, vlera takuese 39.593 euro, data e regjistrimit 10.12.2010, data e blerjes 19.11.2007,

adresa rruga "****", nd. ***, apartamenti ***, Njësia Administrative nr. 6, Tiranë. Burimi i krijimit, kredi bankare shuma 26.000 euro. Kjo kredi është marrë në Bankën Emporiki për 15 vite, por që është shlyer nga ana ime dhe e b/shortes në korrik 2016, sipas deklarimeve të bëra pranë ILDKPKI. Kursime familjare, shuma 13.593 euro, nga puna si oficer policie që prej shtatorit të vitit 2000, si dhe e b/shortes Iva Shehaj, si mjeke pranë strukturave policore prej shtatorit 2005. Pagesa e blerjes së kësaj prone është në 3 këste, nga të cilat 7.000 euro, kursime të deriatëhershme. Nëntor 2007 kësti i dytë 26.000 euro, marrë kredi nga banka dhe kësti i tretë ishte në vlerën 6.593 euro, si garanci dhe do i jepej kur të merreshin çelësat e apartamentit. Shuma e kështit të tretë ishin kursime të mëparshme dhe pjesa tjetër të ardhura përgjatë periudhës nga koha kur u nënshkrua kontrata deri në shlyerjen përfundimtare të vlerës në dhjetor 2008. Vlera 39.593 euro. Zotëron 100%. Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë huaje nr. *** rep, nr. *** kol, dhjetor 2007, me palë Emporiki Bank dhe huamarrës Gentjan dhe Iva Shehaj, dorëzanës shoqëria "****" ShPK, për kredi në vlerën 26.000 euro, me qëllim përdorimin nga huamarrësi për financimin e nevojave të tij për blerjen e një apartamenti me sip. 94.27 m², në Yzberisht, Tiranë, në përputhje me kontratën e datës 19 nëntor 2007, me nr. rep. ***, kol. ***, nënshkruar ndërmjet shoqërisë "****" ShPK (sipërmarrës) dhe Gentjan Shehaj (porositës). Periudha e huas është 180 muaj.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 04.11.2010, me palë shitës shoqëria "****" ShPK, dhe blerës Gentjan Shehaj, për pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, lloji apartament me sip. 85.7 m², e ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 35.994 euro, paguar jashtë zyrës noteriale. Pala shitëse deklaron se për shitjen e apartamentit ka marrë në dorëzim shumën 39.640 euro, duke përfshirë në këtë pagesë edhe çmimin e sipërfaqes së përbashkët. Pala blerëse deklaron se ka vullnet të plotë për rendimin e pasurisë së blerë, me barrë hipotekore në favor të Emporiki Bank, meqenëse çmimi kontraktor është lëvruar kryesisht me kredi bankare nga kjo bankë. B/lidhur praktika.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT PRANË A.M.P

 ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2 me shkresën nr. *** prot, datë 16.10.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e llojit apartament me sip. 85.7 m². Bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë me nr. ***, zk. ***, e llojit apartament, me sip. 85.7 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, regjistruar në datë 10.12.2010. B/lidhur praktika.
- Kontratë hipoteke nr. *** rep, nr. *** kol, datë 29.09.2011, me palë banka Emporiki dhe hipotekues Gentjan dhe Iva Shehaj, për kredinë në vlerën 21.897 euro, kontratë huaje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 17.12.2007, ndryshuar me kontratën nr. *** rep, nr. *** kol, datë 29.09.2011. Objekti i kësaj kontrate është hipotekimi në favor të bankës, për pasurinë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 85.7 m², në emër të Gentjan Shehaj, ndodhur në Yzberisht, Tiranë. B/lidhur praktika.

 ABI Bank me shkresën nr. *** prot, datë 15.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj llogari në euro. Të dhënat e llogarisë janë për periudhën 01.12.2010 - 04.10.2016, ku konstatohen shlyerjet e aseteve të kredisë bankare dhe interesave, në vlerën totale 32.796 euro. Konstatohet se në datën 07.07.2016, subjekti krediton vlerën 15.100 euro me përshkrimin "Të ardhura, kursime familjare" dhe në datën 28.07.2016 transferon verën 14.623 euro, për pagesë kredie.

✚ ABI Bank me e-mailin e datës 04.12.2023, ka b/lidhur dokumentacionin si më poshtë: Kontratë huaje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 17.12.2007, me palë Emporiki Bank dhe huamarrës Gentjan dhe Iva Shehaj, dorëzanës shoqëria "****" ShPK, për kredi në vlerën 26.000 euro, me qëllim përdorimin nga huamarrësi për financimin e nevojave të tij për blerjen e një apartamenti me sip. 94.27 m², në Yzberisht, Tiranë, ne përputhje me kontratën e datës 19.11.2007, me rep. ***, kol. ***, nënshkruar ndërmjet shoqërisë "****" ShPK (sipërmarrës) dhe Gentjan Shehaj (porositës). Periudha e huasë është 180 muaj. B/lidhur praktika.

- Kontratë hipoteke nr. *** rep, nr. *** kol, datë 17.12.2007, me palë Emporiki Bank dhe hipotekues shoqëria "****" ShPK, me objekt hipotekimin në favor të bankës të një pasurie me sipërfaqe 966 m², në emër të shoqërisë "****" ShPK, për shlyerjen e kredisë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 17.12.2007, në vlerën 26.000 euro që banka i ka dhënë huamarrësit Gentjan Shehaj. B/lidhur praktika.
- Kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 29.09.2011, për disa ndryshime në kontratën nr. *** rep, nr. *** kol, datë 17.12.2007, me palë Emporiki Bank, Gentjan dhe Iva Shehaj. Ndër të tjera në kontratë citohet se vihet hipoteke e radhës së parë në favor të bankës mbi pronën në pronësi të Gentjan Shehaj, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, apartament me sip. 85.7 m², e ndodhur në Yzberisht, Tiranë. B/lidhur praktika.

✚ ISSH me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon se shtetasi R.D. nga muaji korrik 2009 - korrik 2019 ka përfutur pension të parakohshëm ushtarak në masën 26.207 lekë, nga muaji gusht 2019, pension pleqërie në masën 36.422 lekë dhe pension suplementar në masën 17.566 lekë. Konfirmon se shtetasja Zh.D, nga muaji korrik 2009 - maj 2017, ka përfutur pension të parakohshëm ushtarak në masën 20.225 lekë, nga muaji maj 2017, pension pleqërie në masën 35.608 lekë dhe pension suplementar në masën 14.411 lekë. (p.s. Shtetasit R.D. dhe Zh.D janë vjehrrë dhe vjehrra e subjektit).

✚ ISSH. Drejtoria e Arkivit Qendror me shkresën nr. V-prot, datë 23.08.2023, konfirmon punësimin e shtetasve: R.D, për periudhën 1990 - 1991 dhe Zh.D, për periudhën 1981 - 1983.

✚ QKB web është shkarkuar ekstrakt historik i personit fizik V.P., me Nipt. K37510****I, regjistruar në vitin 1997, me objekt, "Përpunim ulliri dhe tregtimi i nënprodukteve të tije", me adresë në Fier, Aranitas, me status aktiv. (p.s: Shtetasi V.P. është i afërm i subjektit).

Në ILDKPKI është administruar dokumentacioni si më poshtë:

29. Shkresë nga ABI Bank, nr. *** prot, datë 07.11.2017, që konfirmon se Gentjan Shehaj, është financuar në datë 28.12.2007, në vlerën 26.000 euro kredi për blerje apartamenti, mbyllur para afatit në datë 28.07.2016.

Deklarata Para Fillimit të detyrës 2017, ku subjekti ka deklaruar: "Në fillim të muajit korrik 2016 kam marrë hua pa interes dy personave (të afërmit e mi) për të shlyer kredinë që kam pasur pranë ABI Bank, konkretisht, 7.000 euro dhe 2.000 euro. Marrë hua shuma 7.000 euro shtetasit R.D. (Vjehrrë), mbetur pa shlyer 700 euro. Pa kontratë noteriale. Marrë 2.000 euro shtetasit V.P. (djali i tezes), shlyer në fillim të muajit tetor 2016. Pa kontratë noteriale.

- Deklarata Periodike Vjetore 2018, ku subjekti ka deklaruar: Gjatë periudhës janar - dhjetor 2018 kam ardhur dhe rregulluar banesën, konkretisht llyerje dhe punime 80.000 lekë, punime hidraulike dhe elektrike 45.000 lekë, ardhim banese 900.000 lekë, totali 1.025.000 lekë.
- Deklarata Periodike Vjetore 2019, ku subjekti ka deklaruar: Blerë televizor Sony 100.000 lekë. Blerje e mobles së Kuzhinë Gatimi 300.000 lekë. Pajisje kuzhine 210.756 lekë.

- Deklarata Periodike Vjetore 2020, ku subjekti ka deklaruar: Blerja e disa pajisjeve elektroshtëpiake 182.000 lekë.

Deklaratë e thjeshtë, datë 16.06.2022, nga R.D. i cili deklaroi se gjatë vitit 2017, dhëndri i tij Gentjan Shehaj, i ka patur detyrim shumë 700 euro, kjo shumë ka qenë e mbartur nga një borxh që i kishte dhënë në vitin 2016, dhe i është kthyer gjatë vitit 2017. Burimi i kësaj shume ka qenë nga të ardhurat nga kursime familjare, si dhe shuma e përfituar nga shitja në vitin 2016 e një sipërfaqe toke në fshatin R, Korçë.

- Faturë shitje dt. 01.10.2018 nga "****" ShPK, blerës Gentjan Shehaj, vlera totale 128.520 lekë.
- Faturë shitje dt. 18.09.2018 nga "****" ShPK, blerës Gentjan Shehaj, vlera totale 224.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje, dt. 20.10.2018, nga S.J. PF, për Gentjan Shehaj, për punime alumini, vlera totale 75.600 lekë.

Deklaratë e thjeshtë datë 20.06.2022, nga B. M. PF, i cili deklaroi se në vitin 2018, Gentjan Shehaj ka porositur mobilie, që janë prodhuar dhe montuar nga ana e tyre në banesë, në vlerën totale 300.000 lekë, për të cilat ka lëshuar fature, por për shkak të kohës së gjatë nuk e disponon.

- Faturë nga Studio "****", datë 16.08.2018, për Iva Shehaj, vlera totale 159.970 lekë.
- Faturë tatimore shitje, datë 11.05.2019 nga "****", për Iva Shehaj, vlera totale 102.570 lekë.
- Faturë tatimore shitje, datë 12.11.2019 nga "****" ShPK, për Iva Shehaj, vlera totale 104.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje, datë 27.12.2019 nga "****" ShPK, për Iva Shehaj, vlera totale 106.756 lekë.
- Faturë tatimore shitje, datë 18.01.2020 nga "****" ShPK, për Iva Shehaj, vlera totale 100.000 lekë.
- Faturë tatimore shitje, datë 18.01.2020 nga "****" ShPK, për Iva Shehaj, vlera totale 76.000 lekë.

30. Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me blerjen e apartamentit me sipërfaqe 85.70 m², mënyrën e blerjes, akomodimit, shlyerjes së kredisë dhe borxheve që lidhen me këtë kredi, si më poshtë:

- Kontrata paraprake për blerjen e apartamentit të deklaruar, është lidhur ndërmjet tij dhe z. A.P, në prani të noteres G.Sh., me nr. *** rep dhe nr. *** kol. Afatet dhe mënyra e pagesës së këtij apartamenti janë përcaktuar në nenin 3 të kontratës.

Ashtu siç e ka deklaruar gjatë procesit të deklarimit vjetor, kësti i parë është bërë nga ana e tij menjëherë pas lidhjes së kontratës, pra në datën 17.11.2007, në vlerën 7.000 euro. Kësti i dytë, referuar kontratës, është bërë brenda muajit dhjetor 2007, nga llogaria e tij e hapur në atë kohë pranë Emporiki Bank në llogarinë e firmës "****". Për të vërtetuar kalimin e lekëve nga ana e tij tek firma, ka marrë një deklaratë të lëshuar nga pronari i firmës "****", z. A.P.

31. Ndërsa kësti i tretë, është paguar gjatë vitit 2008, me saktësi për shkak kohës së gjatë që ka kaluar, nuk i kujtohet data e saktë dhe nuk mund të gjej ndonjë dokument për këtë pagesë. Por për të vërtetuar këtë pagesë i referohet deklaratës së lëshuar nga pronari i firmës "****" z. A.P. Subjekti sqaron se ka filluar të banojë në këtë apartament, në muajt e parë të vitit 2008. Në atë kohë për shkak të investimit që kanë bërë në blerjen e shtëpisë, nuk kanë bërë shpenzime për mobilimin e saj. Kanë patur disa pajisje apo mobilje të cilat i kanë patur gjatë kohës që kanë jetuar me qira dhe ato i kanë transferuar në apartamentin e ri. Me pajisje apo mobilie ka parasysh mjetet e nevojshme për të jetuar, të cilat i kanë marrë të përdorura. Në total, me sa i kujtohet, mund të kenë shpenzuar rreth 100.000 lekë. Shpenzime këto që janë shtrirë në kohë nga viti 2006, kohë kur kanë banuar me qira në një banesë gjysmë të mobiluar deri në vitin 2008, koha kur u futën në shtëpinë e re. Arredimi i kësaj shtëpi është bërë pas vitit 2018, kohë kjo, kur kanë filluar të kursejnë pas mbylljes së kredisë në vitin 2016. Investimet dhe shpenzimet e bëra janë deklaruar nga ana e tij në deklaratimet vjetore. Sqaron se ka shpenzuar për arredimin e apartamentit, në total rreth 1.817.756

lekë, nga të cilat ka dorëzuar fatura dhe dokumente për blerjet e bëra në vlerën 1.378.876 lekë. Nuk ka mundur të sigurojë fatura për shumën 438.880 lekë, që konsistojnë në blerjen e kuzhinës së gatimit, disa punime në vlera të pakta hidraulike dhe elektrike, si dhe blerja e dyerve të brendshme dhe blinduesve të parketit.

32. Në lidhje me adresat ku ka banuar para blerjes së këtij apartamenti, sqaron si më poshtë: Pas përfundimit të shkollës së lartë, dhe emërimit me punë në Komisaratin e Policisë Elbasan, në shtator të vitit 2000 deri në mars të vitit 2004, ka jetuar dhe punuar në qytetin e Elbasanit. Në këto vite ka banuar në ambientet e Komisaratis të Policisë Elbasan dhe ambientet e ish Hetuesisë Elbasan. Në muajit maj - korrik 2004, ka qenë në kursin e ILEAS Budapest - Hungari, ku shpenzimet për akomodim dhe ushqim mbuloheshin nga Ministria e Punëve të Brendshme. Në muajin gusht 2004 deri në shkurt të vitit 2006 ka jetuar me qira në banesën në pronësi të shtetasit N.D, banesë kjo që ka qenë përball Spitalit Pediatri, në rrugën "****". Sqaron se është martuar në muajin shtator 2004 (dhe kanë jetuar në këtë banesë, e cila ka patur kompletim modest dhe ata si familje e re nuk kanë patur investime në këtë fazë të jetës. Gjatë kësaj periudhe ka paguar qiranë mujore në vlerën 20.000 lekë. Për shkak të kohës së gjatë, nga momenti që është larguar nga kjo banesë, nuk disponon kontratë qiraje, por është interesuar pas fillimit të procesit të rivlerësimit, për të kontaktuar dhe marrë një deklaratë nga N.D dhe është informuar se ai jeton në Belgjikë. Nëpërmjet telefonit i ka kërkuar ti lëshojë një deklaratë për kohën që ka jetuar me qira në shtëpinë e tij dhe është në pritje të saj. Nëse i vihet në dispozicion do e paraqesë. Nga muaji mars 2006 deri në muajin janar 2008 ka jetuar me qira në një apartament përball ish parkut të autobusëve, në rrugën "****", pallati ku aktualisht është dyqani i firmës "****". Për shkak të kohës së gjatë nuk i kujtohen të dhënat e plota të pronarit, i cili quhej S. Banesa ka patur mobilim të pjesshëm. Gjatë kësaj periudhe ka paguar qiranë mujore në vlerën 20.000 lekë. Për shkak të kohës së gjatë nga momenti që është larguar nga kjo banesë, nuk disponon kontratë qiraje, por është interesuar pas fillimit të procesit të rivlerësimit, për të kontaktuar dhe marrë një deklaratë nga z. S. dhe ka mësuar se ai jeton prej vitesh familjarisht në Greqi dhe nuk ka mundur të lidhet dot me të. Nëse do mundet të kontaktojë dhe të sigurojë kontratën e qirasë ose një deklaratë nga z. S, do e vendosë në dispozicion. Në lidhje me shlyerjen e kredisë së marrë për blerjen e këtij apartamenti në muajin korrik 2016, në vlerën 15.100 euro, ose rreth 2.042.577 lekë, sqaron se shuma prej 6.100 euro ka qenë kursime familjare nga ana e tij dhe e bashkëshortes përgjatë viteve. Shuma 7.000 euro është marrë hua nga vjehri R.D. Këto të ardhura janë nga kursimet ndër vite të familjes së vjehrit të tij, si dhe nga shitja e disa tokave që ai ka pasur në fshatin R., Korçë. Ai për këtë shumë i ka lëshuar një deklaratë, ku sqaron burimin e krijimit të këtyre të ardhurave dhe për sa mundet ka bashkëlidhur dhe fotokopje të dokumentacionit vërtetues, si dhe një kërkesë për vetë dhe bashkëshorten, ku i kërkojnë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, vërtetim për pagesën e pensionit kalimtar për vitet 2008 - 2016. Shuma 2.000 euro është marrë hua nga djali im i tezes z. V.P. Këto të ardhura janë nga kursimet dhe fitimet e tij, pasi në atë kohë ai ka pasur aktivitet biznesi "Bar kafe" si dhe "Fabrikë Vaji". Ai për këtë shumë i ka lëshuar një deklaratë, ku sqaron burimin e krijimit të kësaj vlere, ku ka deklaruar numrin e Nipt, dhe është i hapur për të verifikuar burimet e tij financiare.

33. B/lidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë sipërmarrje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 19.11.2007, me palë sipërmarrës shoqëria "****" ShPK dhe porosites Gentjan Shehaj, me objekt ndërtimin e një apartamenti banimi me sipërfaqe banimi 85.7 m² dhe të përbashkët 8.57 m², në total 94.27 m², kati i gjashtë, ndodhur në Yzberisht, Tiranë. Çmimi i shitjes është në vlerën totale 39.593 euro. Kësti i parë prej 7.000 euro do të paguhet

me nënshkrimin e kontratës, kësti i dytë prej 26.000 euro brenda muajit dhjetor 2007 dhe kësti i fundit prej 6.593 euro, me marrjen e çelësave në dorë.

- Mandat arkëtimi nr. ***, dt. 19.11.2007, lëshuar nga shoqëria "****" ShPK, ku rezulton se Gentjan Shehaj ka arkëtuar vlerën 7.000 euro.
- Deklaratë e thjeshtë, datë 11.12.2023, me palë deklarues A.P, i cili deklaron se shtetasi Gentjan Shehaj, ka blerë nga shoqëria "****" ShPK, investitor dhe pronar i së cilës ka qenë deklaruesi, një apartament me sipërfaqe totale 94.2 m², ndodhur në zonën e Kombinatit, afër rrugës së Qelqit, që tani quhet rruga "****". Për shitjen e apartamentit, duke ju referuar dhe kontratës paraprake të shitjes, sqaron se ka marrë këstin e parë prej 7.000 euro nga Gentjan Shehaj, pranë zyrave të firmës "****" ShPK, këstin e dytë brenda muajit dhjetor 2007, me Llogari bankare në Emporiki Bank, dhe këstin i tretë prej 6.593 euro është paguar në zyrat e firmës "****" ShPK, gjatë vitit 2008.
- Relacion shpjegues dërguar nga Gentjan Shehaj pranë ILDKPKI, datë 21.06.2022, ku subjekti sqaron në lidhje me shpenzimet për arredimin dhe punimet e kryera, në apartamentin e deklaruar si më sipër, për periudhën 2018 - 2020, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
- Deklaratë e thjeshtë datë 07.12.2023, ku R.D. deklaron se në muajin korrik 2016, i ka dhënë Gentjan Shehaj, shumën 7.000 euro, me burim kursimet familjare ndër vite dhe shitja e disa tokave në emrin e tij në fshatin R., Korçë. Deklaron se ka punuar për më shumë se 23 vite si oficer në Strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Kombëtar. Gjithashtu b/shortja e tij ka punuar më shumë se 23 vite si oficer në strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes. Sqaron se shuma prej 7.000 euro i është kthyer nga dhëndri në vlerën e plotë, përgjatë viteve 2016 - 2017.
- Deklaratë e thjeshtë, datë 07.12.2023, me deklarues V.P, i cili deklaron se në muajin korrik 2016, i ka dhënë djalit të tezes, shtetasit Gentjan Shehaj, shumën prej 2.000 euro, me burim kursimet e familjes ndër vite, të përfituara nga biznesi që ka patur në atë kohë me Nipt K37510***I, dhe një fabrikë vaji të regjistruar në organet tatimore. Shuma prej 2.000 euro i është kthyer nga Gentjan Shehaj në vlerë të plotë, brenda vitit 2016.
- Vërtetim nga SHISH, datë 18.04.2006, që vërteton se R.D. trajtohet me pagesë kalimtare, për periudhën 31.01.2006 - 31.01.2008, e cila njihet si periudhë sigurimi.
- Shkresë nga SHISH, drejtuar Agjencisë Lokale të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, datë 25.02.2019, për dokumentet e pensionit të pleqërisë të R.D. B/lidhur praktika.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme (5 vërtetime) nga SHISH, për shtetasin R.D., ku konfirmohen pagat bruto për periudhën 1992 - 1995, në vlerën totale rreth 180.000 lekë dhe për periudhën 1997 - 2008, në vlerën totale neto rreth 3.038.000 lekë.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme (5 vërtetime) nga Ministria e Mbrojtjes, për shtetasen Zh.D, ku konfirmohen pagat neto për periudhën 1997 - 2008, në vlerën totale rreth 3.096.000 lekë.
- Vërtetim nga ISSH, dt. 09.12.2023, për llogaritje pension për shtetasen Zh.D. B/lidhur praktika.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 11.06.2016, me palë shitëse R, Zh, A. D, K. P, L. K, Ll. P. dhe J. D., dhe palë blerëse V. J., me objekt shitje pasurinë e llojit arë, me nr. ***, me sip. 2.890 m² vlerën 20.000 lekë.
- Kërkesë nga R.D., drejtuar ISSH, datë 11.12.2023, ku i kërkon vërtetim të pagës së pensionit kalimtar nga koha e fillimit, nga viti 2008 deri në muajin korrik 2016.
- Kërkesë nga Zh.D, drejtuar ISSH, datë 11.12.2023, ku i kërkon vërtetim të pagës së pensionit kalimtar nga koha e fillimit, nga viti 2008 deri në muajin korrik 2016.

34. Me e-mailin e datës 08.01.2024 subjekti ka b/lidhur dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nga ISSH, datë 27.12.2023, që vërteton se R.D. ka përfituar të ardhura nga pension i parakohshëm, për periudhën shkurt 2008 - korrik 2016, në vlerën totale 2.206.381 lekë.
 - Vërtetim nga ISSH, datë 27.12.2023, që vërteton se Zh.D ka përfituar të ardhura nga pension i parakohshëm, për periudhën shtator 2008 - korrik 2016, në vlerën totale 1.508.735 lekë.
35. Bazuar në deklarinë e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se subjekti ka porositur në v. 2007 apartament në Yzberisht, me sipërfaqe totale 94.27 m², në vlerën 39.593 euro, me burim të ardhurat familjare në vlerën 13.593 euro, si dhe kredi bankare në vlerën 26.000 euro pranë ABI Bank (Ish Emporiki Bank), shlyer në v. 2016. Vlera totale e apartamentit është shlyer në v. 2008. Kontrata e shitblerjes për këtë apartament është bërë në v. 2010. Shpenzimet për mobilimin janë deklaruar rreth 100.000 lekë, në momentin e blerjes së tij dhe më pas nga v. 2018 deri në v. 2020, kanë kryer investime arredimi dhe punime, me vlerë totale rreth 1.800.000 lekë, për të cilat ka ruajtur pjesërisht dokumentacion justifikues përkatës (trajtuar më lart).
36. Subjekti ka marrë dy hua në v. 2016 (konkretisht nga vjehtë R.D. në vlerën 7.000 euro dhe djali i tezes V.P., në vlerën 2.000 euro), përdorur për shlyerjen e kredisë bankare në ABI Bank. Ka paraqitur dokumentacion për huatë, si dhe për të ardhurat e R.D dhe Zh.D likuiduar në vitin 2017.
37. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ka shpenzuar për qira banese, për periudhën gusht 2004 shkurt 2006, llogaritur në total rreth 380.000 lekë dhe për periudhën mars 2006 - janar 2008, rreth 440.000 lekë, për të cilat nuk disponon kontrata qiraje për shkak të kohës së gjatë.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, sqarimet e dhëna dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse.
 - ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ si edhe me përgjigjet e ardhura nga bankat dhe institucionet e tjera.
 - ✓ Shpenzimet për qira banese për periudhën gusht 2004 - janar 2008 janë deklaruar dhe llogaritur në total rreth 820.000 lekë dhe shpenzime për arredimin dhe punimet e apartamentit në Yzberisht, Tiranë në shumën rreth 1.917.000 lekë, kryer në vitin 2008 dhe gjatë periudhës 2018 - 2022.
38. 2. Garazh me sipërfaqe totale 23 m², blerë në vlerën 6.000 euro nga unë dhe b/shortja Iva Shehaj. Shuma e paguar në momentin e lidhjes së kontratës 3.000 euro, shuma tjetër 3.000 euro ju shlye ish pronarit në muajin shtator 2022. Numri i pasurisë ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, e regjistruar në ZVRPP Tiranë. Sipërfaqja takuese 11.5 m². Data e regjistrimit 21.12.2021, data e blerjes 02.12.2021, adresa, rruga “****”, nr. ***, Njësia Administrative nr. 6, Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, lidhur para noterit ***ndërmjet meje, b/shortes Iva Shehaj dhe shitësit A.P dhe M.P. Burimi, kursime 3.000 euro. Kësti i parë për blerjen e kësaj prone është 3.000 euro, i cili i është paguar shitësit nëpërmjet BKT, sipas detyrimit ligjor. Pjesa tjetër prej 3.000 euro ju pagua shitësit *** në muajin shtator 2022, nëpërmjet BKT. Vera 6.000 euro. Zotëron 50%.
39. 3. Garazh me sipërfaqe totale 23.7 m², blerë në vlerën 6.500 euro nga unë dhe b/shortja Iva Shehaj. Shuma e paguar në momentin e lidhjes së kontratës 3.000 euro, shuma tjetër 3.500 euro iu shlye ish pronarit në muajin shtator 2022. Numri i pasurisë ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, e regjistruar në ZVRPP Tiranë. Sipërfaqja takuese 11.85 m². Data e regjistrimit 21.12.2021, data e blerjes 02.12.2021, adresa, rruga “****”, nr. ***, Njësia Administrative nr. 6, Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, lidhur para noterit *** ndërmjet meje, b/shortes Iva Shehaj dhe shitësit A. dhe M. P. Burimi, kursime 3.000 euro. Kësti i parë për blerjen e kësaj prone

është 3.000 euro, i cili i është paguar shitësit nëpërmjet BKT, sipas detyrimit ligjor. Pjesa tjetër prej 3.500 euro iu pagua shitësit A.P në muajin shtator 2022 nëpërmjet BKT. Vlera 6.500 euro. Zotëron 50%.

40. Bashkëlidhur deklaratës.

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, me palë shitëse A.P dhe M. P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit garazh me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 23 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 6.000 euro. Kësti i parë prej 3.000 euro do të paguhet në llogarinë bankare të noterit, pas lidhjes së kontratës, ndërsa kësti i dytë prej 3.000 euro do të paguhet nëpërmjet llogarisë bankare si më sipër.
- Mandat pagese nga BKT, datë 03.12.2021, për kryerje pagese nga Gentjan Shehaj, në favor të *** PF, në vlerën 3.000 euro, me përshkrimin "Pagesë sipas kontratës së shitjes, datë 02.12.2021, nr. *** rep, nr. *** kol, kësti i parë".
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, me palë shitëse A. dhe M. P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit garazh me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 23.7 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 6.500 euro. Kësti i parë prej 3.000 euro do të paguhet në llogarinë bankare të noterit, pas lidhjes së kontratës, ndërsa kësti i dytë prej 3.500 euro do të paguhet nëpërmjet llogarisë bankare si më sipër.
- Mandatpagese nga BKT, datë 03.12.2021, për kryerje pagese nga Gentjan Shehaj në favor të *** PF, në vlerën 3.000 euro, me përshkrimin "Pagesë sipas kontratës së shitjes datë 02.12.2021, nr. *** rep, nr. *** kol, kësti i parë".
- Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, me palë deklarues Gentjan dhe Iva Shehaj, të cilët deklarojnë se me kontratat nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, dhe nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, kanë blerë nga shtetasi A.P dhe M.P, dy garazhe me numra pasurie *** dhe ***. Deklarojnë se dy këstet e para, si pagesë për blerjen e garazheve në vlerën 6.000 euro, në respektim të kushteve kontraktore janë të pakthyeshme, ndërsa nga mbyllja dhe realizimi i kontratave të blerjeve mbetet e pashlyer vlera monetare prej 6.500 euro, e cila do të shlyhet brenda datës 05.08.2022.
- Mandatpagesë nga BKT, datë 02.09.2022, për kreditim nga Gentjan Shehaj, në llogari të tij të vlerës 6.500 euro.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE PRANË A.M.P

 **ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2** me shkresën nr. *** prot, datë 16.10.2023, konfirmon në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj, pasuritë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk ***, e llojit garazh, me sip. 23 m², dhe nr. ***, vol. ***,fq. ***, zk. ***, e llojit garazh, me sip. 23.7 m². B/lidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, me palë shitës A.P dhe M.P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit garazh me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 23 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 6.000 euro. Kësti i parë prej 3.000 euro do të paguhet në llogarinë bankare noterit, pas lidhjes së kontratës, ndërsa kësti i dytë prej 3.000 euro do të paguhet nëpërmjet llogarisë bankare si më sipër. B/lidhur praktika
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë me nr. ***, zk. ***, me sip. 23 m², vlera 6.000 euro, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj, regjistruar në datë 21.12.2021.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, me palë shitëse A.P dhe M.P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit garazh me nr. ***, vol. ***, fq.

***, me sip. 23.7 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 6.500 euro. Kësti i parë prej 3.000 euro do të paguhet në llogarinë bankare të noterit, pas lidhjes së kontratës, ndërsa kësti i dytë prej 3.500 euro do të paguhet nëpërmjet llogarisë bankare si më sipër. B/lidhur praktika.

- Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë me nr. ***, zk. ***, me sip. 23.7 m², vlera 6.500 euro, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj, regjistruar në datë 21.12.2021.

 BKT me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, llogari në euro, ku konstatohet se në datën 02.09.2022 subjekti krediton 6.500 euro, të cilat i transferon me përshkrimin "Gentjan Shehaj në favor të A.P, sipas deklaratës noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 02.12.2021". Gjendja e llogarisë në datë 17.02.2023, rezulton në vlerën 18 euro.

Bazuar në deklarinimin e subjektit dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se:

- Subjekti ka blerë në vitin 2021, dy garazhe të deklaruara si më sipër, me sip. 23 m² dhe 23.7 m², në vlerën totale 12.500 euro, me burim të ardhurat familjare. Shlyerja e detyrimit për këto dy garazhe është bërë në v. 2022.
- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 2 dhe BKT.
- ✓ Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ si edhe me përgjigjet e ardhura nga institucionet.

41. 4. Njësi biznesi me sipërfaqe totale 49.8 m², nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, data e regjistrimit 28.02.2022, data e blerjes 15.02.2022, adresa, Bulevardi "****", Njësia Administrative nr. 5, Tiranë. Vlera 63.000 euro. Burimi 49.500 euro kredi bankare, marrë nga ana ime dhe e b/shortes pranë BKT, me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, lidhur në prani të noterit E.M, në vlerën 9.650.000 lekë, shumë kjo e cila është përdorur për blerjen e dy njësive nga ana jonë. Shuma 13.500 euro, kursime familjare nga puna si oficer policie, si dhe i b/shortes si mjeke. Pagesa e blerjes së kësaj prone është në dy këste, nga të cilat 13.500 euro, kursime të deri atëherëshme, shkurt 2022. Kësti i dytë 49.500 euro, marrë kredi nga banka në datën 16.03.2022. Të dy këstet janë paguar nëpërmjet noterit A.B sipas detyrimeve ligjore. Vlera 63.000 euro. Zotëron 50%.

42. 5. Njësi biznesi me sipërfaqe totale 52.8 m², nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, data e regjistrimit 28.02.2022, data e blerjes 15.02.2022, adresa, Bulevardi "****", Njësia Administrative nr. 5, Tiranë. Vlera 33.000 euro. Burimi, kredi bankare, shuma 25.500 euro, marrë nga ana ime dhe e b/shortes pranë BKT, me kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, lidhur në prani të noterit E.M, në vlerën 9.650.000 lekë. Shuma 7.500 euro, është marrë hua nga babai A.Sh, i cili e ka depozituar këtë shumë në muajin shkurt 2022 në llogarinë time individuale pranë BKT. Pagesa e blerjes së kësaj prone është në dy këste, nga të cilat 7.500 euro marrë hua nga babai dhe kësti i dytë 25.500 euro, marrë kredi nga banka në datën 16.03.2022. Të dy këstet janë paguar nëpërmjet noterit A.B, sipas detyrimeve ligjore. Vlera 33.000 euro. Zotëron 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, me palë shitëse M.P dhe A.P. dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 49.8 m², Rruga "****", Tiranë, në vlerën 63.000 euro. Kësti i parë prej 13.500 euro do të paguhet në llogarinë e noterit menjëherë pas lidhjes së kontratës, ndërsa shuma 49.500 euro do të likuidohet pas marrjes së kredisë në BKT.

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, me palë shitëse A.P dhe M.P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 52.8 m², Rruga "****", Tiranë, në vlerën 33.000 euro. Kësti i parë prej 7.500 euro do të paguhet në llogarinë e noterit menjëherë pas lidhjes së kontratës, ndërsa shuma 25.500 euro do të likuidohet pas marrjes së kredisë në BKT.
- Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 18.02.2022, me palë deklarues Gentjan Shehaj, i cili deklaroi se bashkë me b/shorten ka nënshkruar kontratën nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022 dhe nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, për blerjen e dy njësive me numër pasurie *** dhe ***, nga shtetasit A.P, dhe M.P. Në këto dy pasuri vlera e investimit të kryer nga A.P është në shumën prej 9.000 euro. Këtë shumë e njeh si detyrim dhe do ta shlyejë nëpërmjet bankës ose në dorë. Shuma 4.500 euro do të shlyhet brenda datës 30.07.2023 dhe shuma 4.500 euro brenda datës 30.12.2023.
- Mandatpagesë nga BKT, datë 16.02.2022, për kreditim nga Gentjan Shehaj në llogari të tij, të vlerës 13.515 euro.
- Mandatpagesë nga BKT, datë 16.02.2022, për kreditim nga A.Sh, në llogari të Gentjan Shehaj, të vlerës 7.500 euro.
- Mandatpagesë nga BKT, datë 16.02.2022, për kryerje pagese nga Gentjan Shehaj, në favor të *** PF, të vlerës 21.000 euro, me përshkrimin “Kalim kësti i parë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, shuma 13.500 euro dhe kontrata nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, shuma 7.500 euro”
- Kontratë kredie bankare nr. *** rep, nr. *** kol, datë 16.03.2022, me palë kredidhënës BKT dhe kredimarrës Gentjan dhe Iva Shehaj, për kredi në vlerën 9.650.000 lekë. Sigurimi i kredisë do të kryhet me hipotekimin në favor të bankës, të pasurive të llojit njësi me sip. 52.8 m², me numër pasurie ***, Rruga "****", Tiranë, si dhe njësi me sip. 49.8 m², me numër pasurie ***, rruga “****” Tiranë, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj.
- Mandatpagesë nga BKT, datë 24.03.2022, për kryerje pagese nga Gentjan Shehaj, në favor të *** PF, të vlerës 9.112.600 lekë, me përshkrimin "Kalim kësti i fundit sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022 dhe kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022".
- Mandatpagesë nga BKT, datë 25.03.2022, për kryerje pagese nga Gentjan Shehaj, në favor të A.P, të vlerës 447.100 lekë, me përshkrimin “Kalim shume për diferencë kursi këmbimi nga kredia për kontratat e shitjes nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022 dhe nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022”.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMITPRANË A.M.P

 ASHK Drejtoria Vendore Tiranë Jug, me shkresën nr. *** prot, datë 27.09.2023, konfirmon në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj, pasuritë me nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e llojit njësi me sip. *** m² dhe nr. ***, vol. ***, fq. ***, zk. ***, e llojit njësi me sip. 52.8 m². B/lidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, me palë shitës M.P dhe A.P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 49.8 m², Rruga "****", Tiranë, në vlerën 63.000 euro. Kësti i parë prej 13.500 euro do të paguhet në llogarinë e noterit menjëherë pas lidhjes së kontratës, ndërsa shuma 49.500 euro do të likuidohet pas marrjes së kredisë në BKT. B/lidhur praktika.

- Kartela e pasurisë së paluajtshme, datë 28.02.2022, për pasurinë me nr. ***, e llojit njësi, me sip. 49.8 m², e ndodhur në rrugën "****", Tiranë, vlera 63.000 euro, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, me palë shitës A.P dhe M.P, dhe blerës Gentjan dhe Iva Shehaj, për pasurinë e llojit njësi, me nr. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 52.8 m², rruga "****", Tiranë, në vlerën 33.000 euro. Kësti i parë prej 7.500 euro do të paguhet në llogarinë e noterit menjëherë pas lidhjes së kontratës, ndërsa shuma 25.500 euro do të likuidohet pas marrjes së kredisë në BKT. B/lidhur praktika.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme, datë 28.02.2022, për pasurinë me nr. ***, e llojit njësi, me sip. 52.8 m², e ndodhur në rrugën "****", Tiranë, vlera 33.000 euro, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj.

✚ BKT me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, kredi në lekë, disbursuar në datë 23.03.2022, në vlerën 9.650.000 lekë. Në datën 24.03.2022 transferohet vlera 9.112.500 lekë, me përshkrimin "Gentjan Shehaj për A.B, llogari tjetërsim prone, kalim kësti i fundit sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.02.2022 dhe kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.02.2022". Në datën 25.03.2022 transferohet vlera 447.000 lekë, me përshkrimin "Gentjan Shehaj për A.P., kalim diferencë kursi këmbimi nga kredia, për kontratat e shitjes nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.02.2022 dhe *** rep, nr.*** kol, dt. 15.02.2022. Konfirmon llogari në euro, ku konstatohet se në datën 16.02.2022, subjekti krediton vlerën 13.515 euro, ndërsa A.Sh krediton vlerën 7.500 euro. Në të njëjtën datë transferohet vlera 21.000 euro, me përshkrimin "Gentjan Shehaj për A.B., llogari tjetërsim prone, kalim kësti i parë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.02.2022, shumë 13.500 euro dhe kontratë nr. *** rep, nr. *** kol, dt. 15.02.2022, 1500 euro.

✚ ISSH me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon pagat neto të A.Sh, për periudhën janar 2012 deri qershor 2017, nga ARMO, TPD dhe IRTC, në vlerën totale rreth 5.018.000 lekë, nga muaji tetor 2016 përfiton pension pleqërie në masën mujore 42.997 lekë dhe nga muaji korrik 2019, pension nga ligji 29/2019 në masën mujore 11.507 lekë.

Konfirmon se shtetësja Sh. Sh., nga muaji dhjetor 2014 përfiton pension pleqërie në masën mujore 22.664 lekë dhe nga muaji korrik 2019, pension nga ligji 29/2019, në masën mujore 3.488 lekë.

✚ ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. V-prot, datë 23.08.2023, konfirmon punësimin e shtetasve: A.Sh., për periudhën 1970-1975, Sh.M, për periudhën 1973-1974.

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me burimin e krijimit të shumës 7.500 euro nga babai A.Sh, ku sqaron se është nga shitja e banesës në qytetin e Ballshit në vitin 2016. Sqaron se shuma është kaluar në llogarinë pranë BKT nga babai i tij, në datën 16 shkurt 2022 dhe është shlyer nga ana e tij nëpërmjet transferimit nga llogaria në lekë në BKT, në llogarinë në lekë të babait, në datën 30.03.2023. Shuma e shlyer është në vlerën 849.000 lekë, e konvertuar në euro. Burimi i shumës së shlyer është nga kursimet familjare. Borxhi në vlerën 9.000 Euro, është i pasqyruar në deklaratën noteriale me datë 18.02.2022. Kjo shumë është shlyer në dy këste, një në muajin korrik 2023 dhe një në muajin dhjetor 2023. Burimi i shumës së shlyer është nga kursimet familjare.

B/lidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 27.09.2016, me palë shitëse A, Sh, dhe R. Sh, dhe blerës A. dhe S. Z, për pasurinë e llojit apartament, me nr. ***, zk. ***, vol.***, fq. ***, ndodhur në Mallakastër, Ballsh, me sip. 86 m², në vlerën 1.200.000 lekë. Nga kjo

shumë është paguar kapar 400.000 lekë dhe shumën prej 800.000 lekë e kanë depozituar në numrin e Llogarisë së noterit tek Credins Bank.

- Mandat pagesë nga BKT, datë 16.02.2022, për kreditim nga A.Sh, në llogari të Gentjan Shehaj, të vlerës 7.500 euro.
- Mandat pagesë nga BKT, datë 30.03.2023, për kreditim nga Gentjan Shehaj, në favor të A.Sh, të vlerës 850.000 lekë, me përshkrimin “Shlyerje detyrimi 7.500 euro”. Deklaratë noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 18.02.2022, me palë deklaruese Gentjan Shehaj, i cili deklaroi se bashkë me b/shorten ka nënshkruar kontratën nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022 dhe nr. *** rep, nr. *** kol, datë 15.02.2022, për blerjen e dy njësive me numër pasurie *** dhe ***, nga shtetasit A.P dhe M.P. Në këto dy pasuri, vlera e investimit të kryer nga A.P, është në shumën prej 9.000 euro. Këtë shumë e njeh si detyrim dhe do ta shlyejë nëpërmjet bankës, ose në dorë. Shuma 4.500 euro do të shlyhet brenda datës 30.07.2023 dhe shuma 4.500 euro brenda datës 30.12.2023.
- Mandat pagesë nga BKT, datë 10.07.2023, për kreditim nga Gentjan Shehaj për A.P e M.P, me përshkrimin “kalim kësti i parë sipas deklaratës noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 18.02.2022”.
- Mandat pagesë nga BKT, datë 12.12.2023, për kreditim nga Gentjan Shehaj për A.P e M.P, me përshkrimin “kalim kësti i dytë sipas deklaratës noteriale nr. *** rep, nr. *** kol, datë 18.02.2022”.

Në proces verbalin e datës 26.01.2024 subjekti ka sqaruar se të ardhurat e përfituara nga shitja e shtëpisë në Ballsh, në vlerën 1.200.000 lekë, janë përfituar nga babai, nëna dhe gjyshi R.Sh, i cili nuk jeton më prej vitit 2016. Të gjitha këto të ardhura janë menaxhuar nga babai, pasi gjyshi ka jetuar me babin deri në momentin e ndarjes nga jeta. Gjithashtu sqaron se pavarësisht se ka deklaruar si burim shitjen e shtëpisë, babai ka përfituar edhe të ardhura të tjera nga punësimi i tij ndër vite, në kompani private në Uzinën e Naftës në Ballsh, ku ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar shumat që i ka dhënë.

Konkluzion i Trupës Vlerësuese:

Bazuar në deklarinimin e subjektit dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezultoi se:

Subjekti ka blerë në v. 2022, dy njësi në Bulevardin “****” me sip. 49.8 m² dhe 52.8 m², në vlerën totale 96.000 euro, me burim të ardhurat familjare në vlerën 13.500 euro, hua nga babai A.Sh, në vlerën 7.500 euro dhe kredi bankar në BKT, në vlerën 9.650.000 lekë. Gjithashtu subjekti ka shlyer edhe një detyrim ndaj shitësve, si investim i kryer nga ana e tyre në këto pasuri në vlerën totale 9.000 euro, për periudhën korrik - dhjetor 2023 (pas dorëzimit të deklaratës së vlerësimit kalimtar).

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e institucioneve përkatëse.
- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime si dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me burimin e vlerës 7.500 euro dhënë hua nga babai i tij në vitin 2022, shlyer në muajin mars 2023, nëpërmjet BKT. (pas dorëzimit të deklaratës së vlerësimit kalimtar).

43. 6. Llogari bankare "Future", në emër të djalit tim S. Shehaj, pranë bankës Intesa Sanpaolo, çelur në datë 05.06.2006, nga banka Amerikane (e kohës) me rastin e lindjes së fëmijës në datën 01.06.2006 (dita e fëmijëve). Vlera në llogari mund të tërhiqet nga djali pasi të mbushë 18 vjeç. Vlera rreth 19.800 lekë.

HETIMI I KRYER NGA TRUPA E VLERËSIMIT PRANË A.M.P.

✚ Intesa Sanpaolo Bank me shkresën nr. **** prot, datë 21.09.2023, konfirmon në emër të S. Shehaj, llogari në lekë, çelur në datë 08.06.2006. Gjendja e llogarisë në datë 17.02.2023, në vlerën 18.318 lekë.

✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank.

44. 7. Gjendje cash, në fund të vitit 2022, kam gjendje cash në shumën 645.000 lekë. Kjo shumë është siguruar nga paga ime dhe e b/shortes sime Iva Shehaj.

✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhura të përfituara nga b/shortja ime Iva Shehaj, si mjeke në strukturat e Policisë së Shtetit, në periudhën shtator 2005 - shkurt 2015. Shuma 5.423.082 lekë.
- Të ardhura të përfituara nga b/shortja ime Iva Shehaj, si konsulentë e jashtme pranë Qendrës Sociale Jonatan, në periudhën mars 2012 - dhjetor 2016, punë kjo me kohë të pjesshme, tërhequr pranë Raiffeisen Bank. Shuma 1.160.000 lekë.
- Të ardhura nga paga e b/shortes Iva Shehaj, si mjeke pranë kompanisë MRDC, në periudhën prill - dhjetor 2016 dhe gjatë vitit 2018 dhe janar 2019, të tërhequra në bankën Sanpaolo. Shuma rreth 22.000 euro.
- Të ardhura nga paga e b/shortes Iva Shehaj, pranë Spitalit “****”, Tiranë, për periudhën 24 janar - 31 dhjetor 2017, të tërhequra pranë Raiffeisen Bank. Shuma 530.108 lekë.
- Të ardhura nga paga e b/shortes Iva Shehaj, pranë Spitalit ***, Tiranë, në periudhën dhjetor 2018 - 16 shkurt 2023. Shuma 7.710.200 lekë.
- Të ardhura nga pagesa e b/shortes Iva Shehaj, si pedagoge pranë Albanian University. Shuma 20.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 04.10.2018, për llogari në lekë, në emër të Iva Shehaj, ku konfirmohen kreditimet dhe debitimet totale, për periudhën 2005 - 2018.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 18.01.2023, për llogari në lekë, në emër të Iva Shehaj PF, për periudhën 28.02.2022 deri më datë 09.01.2023.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 21.04.2018, llogari në lekë, në emër të Iva Shehaj, për periudhën 06.01.2012 deri më datë 29.12.2017.

✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr.* prot, datë 10.08.2023, konfirmon Llogari page në lekë, në emër të Iva Shehaj, ku konfirmohen kreditimet nga paga dhe shpërblime, sigurime shoqërore, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve, Jonatan Center dhe *** Tirana, për periudhën 16.09.2005 - 11.09.2020, në vlerën totale rreth 9.000.000 lekë. Gjendja e llogarisë në datë 17.02.2023, në vlerën 0 lekë.

✚ Intesa Sanpaolo Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 21.09.2023, konfirmon në emër të Iva Shehaj, Llogari në euro, ku konstatohet transferta midis llogarive, për periudhën 04.05.2016 - 26.04.2019. (debitime kreditime total 24.185 euro).

✚ FI Bank me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Iva Shehaj, llogari page në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga, për periudhën 09.06.2020 - 10.02.2022, në vlerën totale rreth 3.228.000 lekë. Llogaria rezulton e mbyllur.

- ✚ OTP Bank me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Iva Shehaj llogari në lekë, ku konstatohet se në datën 10.07.2020, kreditohet paga nga “****” ShPK, në vlerën 19.125 lekë.
- ✚ OKB me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon të regjistruar shtetasen Iva Shehaj, si person fizik, me Nipt. M21417***A, regjistruar në datë 17.02.2022, me Objekt veprimtari mjekësore, me seli në Tiranë, rruga “****”, pasuria me nr. ***, me status aktiv.
- ✚ DPT me shkresën nr. V-prot, datë 21.08.2023, konfirmon të regjistruar shtetasit: Iva Shehaj, me Nipt: M21417***A, DRT Tiranë, viti 2022.
- ✚ DRT Tiranë me shkresën nr. *** prot, datë 28.08.2023, konfirmon të regjistruar shtetasen Iva Shehaj, si person fizik, me Nipt: M21417***A, regjistruar në datë 17.02.2022, me objekt, “aktivitete mjekësore”. Fitimi pas tatimit për vitin 2022, rezulton në vlerën 2.042.451 lekë. B/lidhur praktika
- ✚ ISSH me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon pagat neto të Iva Shehaj, për periudhën janar 2012 - korrik 2023.

Në ILDKPKI është administruar:

45. Deklarata Periodike Vjetore 2022, ku b/shortja ka deklaruar: Të ardhura nga aktiviteti sipërmarrës, me Nipt. M21417***A, Iva Shehaj, “shërbime mjekësore”, nga data 18.02.2022 në datë 31.12.2022, vlera 2.180.858 lekë, si rezultat i shërbimeve të ofruara si mjeke laborator prapë spitalit ***, Tiranë.

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes si person fizik me Nipt: M21417***A, ku sqaron se të ardhurat e fituara në shumën 2.042.451 lekë janë deklaruar në formularin e tij si subjekt i deklarimit. Nuk është bërë një ndarje e të ardhurave të fituara si i punësuar dhe si person fizik. Kjo është bërë, pasi të gjitha të ardhurat janë përfutuar nga shërbimi i ofruar prapë spitalit ***, Tiranë. Në lidhje me të ardhurat në euro të përfutuar nga bashkëshortja Iva Shehaj, të kaluara në llogarinë bankare në Intesa Sanpaolo Bank, sqaron se vlera e saktë e pagesës së bërë nga MRDC, për bashkëshorten, përgjatë periudhës 04.05.2016 deri më 26.04.2019, është 24.185 euro.

B/lidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:

- Statement nga ISP Bank, për Llogari në euro në emër të Iva Shehaj, për periudhën 04.05.2016 - 02.04.2019, ku konfirmohen kreditimet nga paga dhe honorarë nga MRDC Fondacion, në vlerën totale 24.185 euro.
- Të ardhurat e b/shortes nga paga, honorarë dhe shpërblime për periudhën shtator 2005 - shkurt 2022. rezultojnë në vlerën totale rreth 12.247.000 lekë + 24.185 euro, konvertuar rreth 15.042.000 lekë.
- Fitimi neto nga aktiviteti si person fizik i b/shortes për vitin 2022, në vlerën rreth 2.042.000 lekë, konfirmuar nga DRT Tiranë.
- Të ardhura të përfutuar nga ana ime si paga, shpërblime, dieta, taksë solidariteti dhe çdo e ardhur tjetër nga puna si punonjës policie, prej muajit shtator 2000 deri në datën 31.12.2022, shuma 21.574.122 lekë.
- Të ardhura të përfutuar si punonjës policie i nivelit zbatues në Komisaratin e Policisë Mallakastër, maj - shtator 1997, rreth 43.000 lekë.
- Të ardhura të përfutuar në DVP Elbasan në periudhën shtator 2000 - mars 2004, shuma 1.455.350 lekë.

- Të ardhura të përfituara nga SHKB, në periudhën 16.03.2004 - 15.04.2005, shuma 542.908 lekë.
- Të ardhura të përfituara nga struktura e SHKB dhe Policia e Shtetit, mbas datës 15.04.2005 deri më 16.02.2023, të tërhequra në bankën Raiffeisen, shuma 17.122.974 lekë.
- Të ardhura të përfituara nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe të tërhequra nga Tirana Bank, shuma 2.409.890 lekë.
- Të ardhura të përfituara nga qiraja e banesës së prindërve të mi për periudhën 2007- 2009. Kjo banesë është në rrugën “****”, Yzberisht, Tiranë, dhe për një periudhë kohe brenda kësaj periudhe, të ardhurat e kësaj qiraje, prindërit mi kanë dhënë që ti përfitoj unë. Shuma 180.000 lekë.
- Të ardhura të dhuruara nga prindërit në vitin 2016. Kjo shumë është përfituar nga ana e tyre, pasi kanë shitur apartamentin ku kemi jetuar në qytetin e Ballshit. Shuma 200.000 lekë.
- Bursë e përfituar nga Bashkia Tiranë nga djali S. Shehaj, nëpërmjet Credins Bank, për vitet 2016 - 2022. Shuma 153.000 lekë.
- Të ardhura të përfituara nga dhënia me qira e pronës me nr. ***, nga muaji mars 2022. Deklarimi nga kjo qira është për periudhën mars 2022 - 16 shkurt 2023. Këto të ardhura bazuar në kontratën e qirasë nr. *** rep, nr. *** kol, datë 28.02.2022, kanë kaluar nëpërmjet llogarisë time në BKT. Shuma 299.000 lekë.
- Vërtetim nga Raiffeisen Bank, datë 04.10.2018, për llogari në lekë në emër të Gentjan Shehaj, ku konfirmohen kreditimet dhe debitimet totale, për periudhën 2005 - 2018.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, datë 15.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Gentjan Shehaj, për periudhën 04.04.2018 deri më datë 06.02.2023.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 18.01.2023, për llogari në lekë në emër të Gentjan Shehaj, për periudhën 16.02.2022 deri më datë 16.12.2022.
- Nxjerrje llogarie nga BKT, datë 18.01.2023, për llogari në euro në emër të Gentjan Shehaj, për periudhën 16.02.2022 deri më datë 06.09.2022.
- Nxjerrje llogarie nga Tirana Bank, për llogari në lekë, në emër të Gentjan Shehaj, për periudhën 06.01.2011 deri më datë 17.12.2022.
- Vërtetim page nga DVP Elbasan, datë 12.04.2018, që vërteton se Gentjan Shehaj, për periudhën 01.10.2000 - 15.04.2004, ka përfituar të ardhura nga paga në vlerën totale neto prej 1.304.677 lekë, nga shpërblimet në vlerën 82.606 lekë, taksa e solidaritetit në vlerën totale 62.667 lekë dhe dieta 5.400 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme datë 12.04.2018, ku konfirmohen pagat neto të Gentjan Shehaj, për periudhën mars 2004 - qershor 2005, në vlerën totale 639.284 lekë.
- Deklaratë e thjeshtë (me shkrim dore), datë 16.04.2018, me deklarues A.Sh, i cili deklaron se në muajin shtator 2016 i ka dhënë djalit të tij Gentjan Shehaj, shumën prej 200.000 lekë, të përfituara nga shitja e shtëpive që kishte në qytetin e Ballshit.
- Deklaratë e thjeshtë (me shkrim dore), me deklarues A.Sh, i cili deklaron se nga viti 2007 - 2009, i ka dhënë djalit Gentjan Shehaj shumën prej 180.000 lekë të fituara nga qiraja e shtëpisë që kishte blerë në Tiranë.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 27.09.2016, me palë shitëse A, Sh, dhe R. Sh, dhe blerës A. dhe S.Z, për pasurinë e llojit apartament, me nr. ***, zk ***, vol.***, fq. ***, ndodhur në Mallakastër, Ballsh, me sip. 86.7m², në vlerën 1.200.000 lekë. Nga kjo

shumë është paguar kapar 400.000 lekë dhe shumën prej 800.000 lekë e kanë depozitar në numrin e llogarisë së noterit tek Credins Bank. B/lidhur praktika.

- Kontratë qiraje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 28.02.2022, me palë qiradhënëse Gentjan dhe Iva Shehaj dhe qiramarrës E.B, me objekt dhënien me qira të pasurisë me nr. ***, me sip. 52.8 m2, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me afat dy vjeçar, për periudhën 01.03.2022 - 29.02.2024, në vlerën mujore bruto 27.000 lekë, i cili përfshin tatimin mbi qiranë. Tatimi mbi qiranë do të paguhet nga qiramarrësi, duke llogaritur nga çmimi i qirasë, por pa cenuar vlerën neto dysHEME, prej 23.000 lekë.

✚ Raiffeisen Bank, me shkresën nr. *** prot, datë 10.08.2023, konfirmon llogari page në lekë, në emër të Gentjan Shehaj, ku konfirmohen kreditimet nga paga, shpërblime, dieta, veshje, honorarë, për periudhën 05.05.2005 - 23.12.2010 dhe 06.11.2012 - 17.02.2023, në vlerën totale rreth 16.527.000 lekë. Gjendja e llogarisë në datë 17.02.2023, në vlerën 595 lekë.

✚ BKT me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga qiraja nga F.B, për periudhën 08.03.2022 - 06.02.2023, në vlerën totale rreth 276.000 lekë.

✚ Tirana Bank me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga për periudhën 06.01.2011 - 12.11.2012, në vlerën totale rreth 1.545.000 lekë. Gjendja e llogarisë në datë 17.02.2023, në vlerën 280 lekë.

✚ ISSH. me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, konfirmon pagat neto të Gentjan Shehaj, për periudhën tetor 2012 - korrik 2023.

Në ILDKPKI është administruar: Deklarata Para Fillimit të Detyrës 2012, ku subjekti ka deklaruar: “Gjatë vitit 2012 kam përfituar çdo muaj të ardhura nga babai në vlerën 13.000 lekë, nga qiraja e apartamentit që babai ka në pronësi në zonën e ish Kombinatit të Mishit Yzberisht. Vlera 130.000 lekë”.

46. Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim në lidhje me kontratën e qirasë së banesës së prindërve të tij, që ka shërbyer si burim për shumën e dhënë në vlerën 180.000 lekë, ku sqaron se për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, prindërit e tij nuk disponojnë kontratë qiraje për dhënien me qira të asaj banese në atë kohë. Është interesuar pas fillimit të procesit të rivlerësimit, për të kontaktuar dhe për të marrë një deklaratë nga shtetasi që ka jetuar gjatë asaj periudhe në atë banesë, por nuk kam mundur të gjejë një lidhje apo të kontaktoj me të. Me sa i kujtohet ai quhej Sh. dhe ishte nga Mamurrasi. Nëse do të kontaktoj dhe të sigurojë kontratën e qirasë ose një deklaratë nga z. Sh, do e vë në dispozicion në kohën më të shpejtë të mundshme. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga qiraja e shtëpisë së babait tim, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar, përgjatë vitit 2012, sqaron se këto të ardhura janë pasqyruar nga ana e tij në deklarimin vjetor të vitit 2012, por janë harruar të pasqyrohen, në deklarimin e rivlerësimit kalimtar. Bashkëlidhur do të gjeni deklaratën e lëshuar nga shtetasi S.A, si person që ka jetuar më qira në atë banesë, gjatë kësaj periudhe, si dhe deklaratën e babait për këtë fakt.

47. B/lidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:

- ✓ Deklaratë e thjeshtë datë 12.12.2023, me deklarues S.A, i cili deklaron se për periudhën janar - dhjetor 2012, ka jetuar me qira në banesën në pronësi të shtetasit A.Sh, në pallatet tek ish fusha e fabrikave të mishit, Yzberisht, rruga “****”. Për shkak të kohës së gjatë, nuk ka ruajtur kontratë qiraje. Përgjatë kësaj periudhe ka paguar qiranë në vlerën 13.000 lekë në muaj.
- ✓ Deklaratë e thjeshtë datë 07.12.2023, me deklarues A.Sh, i cili deklaron se ka patur në pronësi, në zonën e ish Kombinatit të mishit Yzberisht, rruga “****” një banesë, të blerë me kursimet e tij

familjare dhe dy djemve në atë kohë që jetonin në Itali. Aktualisht kjo banesë është në pronësi të djalit A.Sh. Gjatë periudhave të ndryshme kjo banesë është dhënë me qira personave të ndryshëm, që për shkak të kohës së gjatë nuk disponon kontratat e qirasë. Përgjatë viteve 2007 - 2009, nga shuma e përfituar nga qiraja i ka dhënë Gentianit, në total, 180.000 lekë, dhe përgjatë vitit 2012, nga shuma e qirasë i kam dhënë në total 130.000 lekë.

- ✓ Në proces verbalin e datës 12.01.2024, në lidhje me dokumentacionin e pronësisë së apartamentit, tek ish fabrika e mishit në Yzberisht, rruga “****”, Tiranë, në pronësi të babait të tij, A.Sh, nga i cili ka përfituar nga dhënia me qira e këtij apartamenti në vitet 2007 - 2009 dhe 2012, bashkëlidhur paraqet fotokopjen e kontratës së sipërmarrjes, fotokopjen e kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme, si dhe fotokopjen e certifikatës së pronësisë së këtij apartamenti me sipërfaqe 80.6 m².

48. B/lidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë sipërmarrje nr. **** rep, nr. **** kol, datë 25.10.2006, me palë sipërmarrëse shoqëria “****” ShPK dhe porositës A.Sh, për një apartament me sipërfaqe të përgjithshme 87.2 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në vlerën 34.880 euro.
- Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. **** kol, datë 29.05.2009, me palë shitëse shoqëria “****” ShPK, dhe blerës A.Sh, për apartament me numër pasurie ****, ndodhur në Yzberisht, Tiranë, me sip. 80.6 m², në vlerën 34.880 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatë për vërtetim pronësie dt. 09.10.2009, për pasurinë me nr. ****, me sip. 80.6 m², ndodhur në Yzberisht, Tiranë, në emër të A.Sh. B/lidhur praktika.

49. Në proces verbalin e datës 26.01.2024, subjekti ka sqaruar se prindërit e tij në periudhën 2007 - 2016, kanë banuar në qytetin e Ballshit, në shtëpinë në pronësi të tyre, e përfituar nga privatizimi në fillim të viteve 1990, shtëpi kjo e shitur në vitin 2016. Shtëpia në Yzberisht, Tiranë, e cila është lënë me qira, ka si kontribut, siç e ka deklaruar kursimet familjare të prindërve ndër vite, si dhe dy vëllezërve të tij, të cilët jetonin dhe punonin në Itali në atë periudhë. Ky apartament ka kaluar nga babai në emër të vëllait A.S, duke qenë kontribuesi kryesor në blerjen e kësaj shtëpie. Këto janë marrëdhënie midis familjarëve, konkretisht prindërve të mi dhe dy vëllezërve.

50. Me e-mailin e datës 26.1.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Dokumentacion (në gjuhën italiane), për të ardhurat e A.Sh., për v. 2002, në vlerën totale 2.277 euro dhe 7.430 euro.
- Dokumentacion (në gjuhën italiane), për të ardhurat e A.Sh., për v. 2003, në vlerën totale 13.378 euro.
- Dokumentacion (në gjuhën italiane), për të ardhurat e A.Sh., për v. 2004, në vlerën totale 13.193 euro.
- Dokumentacion (në gjuhën italiane), për të ardhurat e A.Sh., për v. 2006, në vlerën totale 13.677 euro, 2.064 euro dhe 875 euro.
- Kontratë dhurimi nr. **** rep, nr. **** kol, datë 15.03.2013, me palë dhuruese A.Sh dhe Sh.Sh, dhe pranues dhurimi A.Sh, me Objekt dhurimin e pasurisë me nr. ****, zk ****, me sip. 80.6 m², ndodhur në Yzberisht Tiranë. B/lidhur praktika.
- ✓ Të ardhurat e subjektit nga pagat dhe shpërblimet, dietat për periudhën tetor 2000 - shkurt 2023, rezultojnë në vlerën totale rreth 20.166.000 lekë.
- ✓ Të ardhurat nga qiraja e njësisë me nr. ****, për periudhën mars 2022 - shkurt 2023, rezultojnë në vlerën totale 276.000 lekë. Detyrimet tatimore sipas përcaktimeve të kontratës, paguhen nga qiramarrësi.

- ✓ Të ardhura të përfituara nga babai i subjektit me burime nga qiraja e apartamentit në Tiranë në total 310.000 lekë për periudhën 2007 - 2009 dhe v. 2012. Prindërit e subjektit kanë jetuar në qytetin e Ballshit deri në v. 2016. kur kanë shitur shtëpinë në këtë qytet.

51. DETYRIME FINANCIARE

- Kredi e marrë nga ana ime dhe e b/shortes Iva Shehaj, nëpërmjet kontratës së lidhur në datën 16.03.2022, me nr. *** rep, nr. *** kol, në prani të noteres E.M. Kredia është marrë në vlerën 9.650.000 lekë, shumë kjo që është përdorur për blerjen e dy njësive nga ana jonë dhe do të shlyhet në total pas 180 muajve, ose 15 vite. Detyrimi 9.223.324 lekë.
- Kontratë kredie bankare nr. *** rep, nr. *** kol, datë 16.03.2022, me kredidhënës BKT dhe kredimarrës Gentjan dhe Iva Shehaj, për kredi në vlerën 9.650.000 lekë. Sigurimi i kredisë do të kryhet me hipotekimin në favor të bankës, të pasurive të Llojit njësi, me sip. 52.8 m², me numër pasurie ***, rruga "****", Tiranë, si dhe njësi me sip. 49.8 m², me numër pasurie ***, rruga "****" Tiranë, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj.

 BKT me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, kredi në lekë, disbursuar në datë 23.03.2022, në vlerën 9.650.000 lekë. Gjendja e kredisë në datë 17.02.2023, rezulton në vlerën 9.223.324 lekë.

Konkluzion i Trupës Vlerësuese:

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.
- ✓ Borxh në vlerën 9.000 euro. Për këtë qëllim kam lëshuar deklaratë noteriale para noterit A.B, me nr. *** rep, nr. *** kol, datë 18.02.2022. Kjo shumë do të shlyhet në dhjetor 2023 dhe është pa interes. Detyrimi 9.000 euro. Trajtuar më lart.
- ✓ Borxh në vlerën 7.500 euro. Kjo shumë është marrë hua për të paguar këstin e parë për blerjen e pronës me nr. ***. Shuma është kaluar në llogarinë time individuale pranë BKT, në muajin shkurt 2022 dhe do të shlyhet në prill 2023 dhe është pa interes. Detyrimi 7.500 euro. Trajtuar më lart.

52. SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur.

Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

Përgjatë vitit 2022 kam kryer këto shpenzime periodike:

Shpenzime për ujë, drita, mesatarisht në një muaj paguaj 5.000 lekë për drita dhe ujë/12 muaj 60.000 lekë. Për numrin tim të telefonit, të b/shortes dhe dy fëmijëve, paguaj 1.800 lekë në muaj/12 muaj 21.600 lekë. Internet dhe TV, kam lidhur kontratë me kompaninë Tring në fillim të vitit 2022 dhe kam paguar rreth 15.000 lekë për të përfituar internet dhe televizion përgjatë vitit 2022. Paguaj detyrimet e mirëmbajtjes së pallatit dhe ashensorit në një vlerë mujore prej 800 lekë/12 muaj 9.600 lekë. Paguaj këstin e kredisë pranë BKT, me një shumë mujore prej 74.130 lekë. Pagesa ka filluar në muajin prill 2022 dhe përgjatë vitit 2022 ka paguar rreth 667.170 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Librezë nga FSHU, në emër të Gentjan Shehaj, rruga "****" ku konstatohen pagesat për Vitin 2022, në vlerën totale rreth 66.000 lekë.

- Formular për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit nga Tring datë 07.01.2020, në emër të Gentjan Shehaj, adresa rruga ”****”, për kontratë familjare 24 mujore, për ofrim shërbime interneti. B/lidhur praktika.
- ✚ FSHU me shkresën nr. *** prot, datë 17.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj një kontratë furnizimi, në instancën Tiranë, adresa bulevardi ”****”, kabina “****”, privat, pagesat për Vitin 2022, në vlerën totale 3.414 lekë. Konfirmon në emër të Gentjan Shehaj një kontratë furnizimi, në instancën Fier, adresa “****”, kabina “****”.
- ✚ UK Fier me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, kontratë në zonën Patos, Fier, për periudhën 2017 - 2023. Pagesat e kryera për Vitin 2022, rezultojnë në vlerën totale 13.248 lekë.
- ✚ UK Fier me shkresën nr. *** prot, datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, kontratë në zonën “****”, Fier, për periudhën 2010 - 2023. Pagesat e kryera për Vitin 2022, rezultojnë në vlerën totale 23.058 lekë.
- ✚ Vodafone Albania sha., me shkresën nr. *** prot, dt. 01.02.2024, konfirmon se në emër të Gentjan Shehaj rezulton numri 0694102**** dhe për Iva Shehaj numri 0694101**** (regjistruar në emër të Akademisë së Policisë).
- ✚ One Albania me shkresën nr. *** prot, datë 26.09.2023, nuk konfirmon të regjistruar numra në shërbimin e telefonisë, në emër të subjektit apo personave të lidhur.
- ✚ Tring me shkresën nr. *** prot, datë 31.08.2023, konfirmon në emër të subjektit, kontratë të nënshkruar në datë 21.12.2020, për ofrim interneti, me vlerë 2.190 lekë në muaj. Kjo kontratë është rinovuar në datë 10.12.2022 dhe ka kryer pagesën për 12 muaj, në vlerën 18.320 lekë. B/lidhur praktika.
- ✚ Abissnet me shkresën nr. V-Prot, datë 04.09.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për periudhën e kërkuar.
- ✚ Digicom me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, nuk konfirmon kontratë të lidhur me subjektin apo personat e lidhur, për shërbime interneti, për periudhën e kërkuar.
- ✚ 14 Shoqëritë Rajonale të UK konfirmojnë se subjekti apo personat e lidhur, nuk figurojnë të kenë lidhur kontrata për shërbim furnizimi me ujë të pijshëm, pranë këtyre shoqërive rajonale.
 - Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në lidhje me dy kontratat e UK Fier, ku sqaron se pagesat e kryera në të dy rastet nuk i përkasin subjektit dhe nuk janë bërë nga ana e tij.
 - Në proces verbalin e datës 12.01.2024 subjekti ka sqaruar në lidhje me kontratën me Ujësjiellës Kanalizimet Tiranë, për banesën në emrin e tij në rrugën “****” pallati ***, shkalla ***, hyrja nr. ***, Njësia Bashkiake nr. 6, Tiranë, se për këtë banesë nuk ka një kontratë me UKT. Pallati i tyre furnizohet me ujë me pus, i hapur ky që nga ndërtimi i pallatit dhe i lidhur me rrjetin e pallatit. Asnjë banor i këtij pallati nuk ka një kontratë me UKT. Nga ana e tij, në momentin që kam blerë këtë apartament, i kam paguar detyrime për lidhje kontratë drita dhe ujë ndërtuesit, por kontrata e ujit, për shkak se në atë kohë rrjeti i ujësjiellësit nuk kishte ardhur në zonë, nuk u lidh. Gjatë gjithë kohës ne furnizohemi me ujë nga pusi që është hapur nga investitori/ndërtuesi i këtij pallati. Në lidhje me deklarin e tij, sqaron se pagesa prej 5.000 lekë i korrespondon vetëm pagesës së dritave, pasi nuk ka pasur detyrime mujore për shpenzim për ujë gjithë këto vite. Në lidhje me shpenzimet mujore për telefoninë celulare sqaron se përgjatë vitit 2022, familja e tij ka përdorur katër numra telefonik me kontratë me kompaninë Telekom (aktualisht ONE Albania). Pagesat për të katër numrat janë fikse mujore në vlerën, 400 lekë për dy numra,

dhe 600 lekë dy numra e tjerë. Shuma totale në vit, që shpenzojnë si familje për telefoninë celulare, është 24.000 lekë. Bashkëlidhur dy fatura të kompanisë One Albania, ku kanë faturuar shumën për muajin tetor dhe nëntor 2022, pagesa këto që janë bërë në muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2022. Këto dy fatura janë bashkëlidhur për të treguar vijueshmërinë e të njëjtës shumë çdo muaj. Veç këtyre katër numrave për të cilët pagesa mujore bëhet nga ana e tij, sqaron se në emrin e tij është dhe një numër që është tërhequr nga subjekti, por përdorues është shtetasi A.I.A, (banues në pallat dhe shok me djalë e tij). Pagesa për këtë numër bëhet nga përdoruesi i këtij numri.

- Në lidhje me konfirmimin e FSHU, e cila konfirmon një kontratë furnizimi, në instancën Fier, adresa "****", kabina "****", familjare, subjekti sqaron me përgjegjësi të plotë, se nuk ka pasur dhe nuk ka asnjë kontratë furnizimi në qytetin e Fierit me FSHU, pra ky konstatim i mësipërm nuk i përket atij.

B/lidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Raport i detajuar telefonik nga One Albania, për muajin tetor 2022, ku konstatohen në emër të Gentjan Shehaj, 4 numra me pagesë totale mujore 1.800 lekë dhe në emër të Iva Shehaj, një numër me pagesë mujore 600 lekë.
- Shpenzimet e deklaruara për ujë, drita, telefoni, internet gjatë periudhës së sipërcituar me kontratë në emër të subjektit dhe b/shortes rezultojnë në total rreth 135.000 lekë.
- Për udhëtimet private personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike) duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022

Përgjatë viteve 2020, 2021, dhe 2022 kam pasur këto udhëtime jashtë vendit:

- Në datat 14 deri në 20 nëntor 2021, unë kam qenë në një vizitë studimore në Finlandë. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit janë paguar nga organizatorët, që ishte projekti i binjakëzimit të BE, midis Akademisë së Sigurisë Tiranë dhe Akademisë respektive të Finlandës dhe Estonisë.
- Në datat 3 deri në 06.05.2022, kam qenë në një vizitë pune në Vjenë, Austri, si pjesë përbërëse e një delegacioni nga Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit. Shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit janë hequr nga Policia e Shtetit, bazuar në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, nxjerrë për këtë qëllim.
- Në datat 28 deri 30.10.2022, b/shortja Iva Shehaj ka qenë në një konferencë mjekësore në Bruksel, Belgjikë. Shpenzimet e udhëtimit prej 175 euro, janë hequr nga ana e saj ndërsa shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit janë hequr nga kompania që organizonte aktivitetin Snibe. Shuma 175 euro.
- Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot, datë 10.08.2023, konfirmon llogari page në lekë, në emër të Gentjan Shehaj, ku konfirmohet kreditim në datën 14.12.2021, në vlerën 12.888 lekë, me përshkrimin "Study visit Finland".

- Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues si dhe sqarime me shkrim në lidhje me udhëtimet jashtë vendit, ku sqaron se:

- Në datat 14 deri 20.11.2021, në zbatim të urdhrin të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. ***, datë 09.11.2021, ka qenë në një vizitë studimore në Finlandë. Të gjitha shpenzimet përgjatë kësaj vizite janë financuar nga projekti i binjakëzimit të Bashkimit Evropian, për rritjen e kapaciteteve të Akademisë së Sigurisë.

- Në datat 03 deri 06.05.2022, në zbatim të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. ***, datë 21.04.2022, ka qenë në një vizitë studimore në Vjenë - Austri. Të gjitha shpenzimet përgjatë kësaj vizite janë financuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
 - Në datat 28 deri 30.10.2022, b/shortja Iva Shehaj ka marrë pjesë në një konferencë mjekësore në Bruksel, Belgjikë. Ashtu siç ka deklaruar dhe në formularin e rivlerësimit kalimtar, shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga ana e saj, ndërsa shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit janë mbuluar nga kompania që organizoi aktivitetin, SNIBE. B/lidhur një kopje e rezervimit që është bërë nga organizatorët, ku është dhe emri i Iva Shehaj dhe përcaktohet që organizatorët mbulojnë shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit, si dhe një fotokopje e certifikatës së pjesëmarrjes dhe axhendës. Gjithashtu, b/lidhur një kopje të fletëve të gjeneruara nga sistemi Tims, për të dhe familjarët.
- B/lidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:
- Urdhër nr. ***, datë 09.11.2021, nga Ministria e Brendshme, për dërgim jashtë shtetit, ku është urdhëruar të shkojnë me shërbim jashtë shtetit, në Helsinki, Finlandë, ndër të tjerë edhe Drejtuesi i Parë Gentjan Shehaj, për periudhën 13.11 - 21.11.2021. Të gjitha shpenzimet do të mbulohen nga pala organizatore.
 - Urdhër nr. ***, datë 21.04.2022, nga Ministria e Brendshme, për dërgim jashtë shtetit, ku është urdhëruar të shkojnë me shërbim jashtë shtetit, në Vjenë, Austri, ndër të tjerë edhe Drejtuesi i Parë Gentjan Shehaj, për periudhën 03 - 06.05.2022.
 - Certifikatë pjesëmarrje për Dr. Iva Shehaj, nga IFCC, për pjesëmarrje konference në Belgjikë, në datën 28.10.2022. B/lidhur praktika.
 - Kopje nga sistemi Tims për shtetasin Gentjan Shehaj, ku konfirmohen lëvizjet si më poshtë:
 - Dalje dt. 14.11.2021 (Lufthansa, Frankfurt, Rinas) - Hyrje dt. 20.11.2021 (Lufthansa Mynih, Rinas).
 - Dalje dt. 03.05.2022 (Austria Airlines, Viena, Rinas) - Hyrje dt.06.05.2022 (Austria Airlines, Viena, Rinas).
 - Kopje nga sistemi Tims për shtetasen Iva Shehaj, ku konfirmohen lëvizjet si më poshtë:
 - Dalje dt. 28.10.2022 (WizzAir, Rinas) - Hyrje dt. 30.10.2022 (Gate, Rinas). Kopje nga sistemi Tims për shtetasit S. dhe E. Shehaj, për të cilët nuk konfirmohen lëvizje jashtë vendit.
 - ✓ Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion në lidhje me udhëtimet e tij për periudhën e mësipërme, ku rezulton se kanë qenë për arsye të punës së tij si Drejtues i Parë. të zhvilluara në Finlandë dhe Austri.
 - ✓ Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private personale të b/shortes së subjektit. gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë të deklaruara rreth 175 euro, konvertuar rreth 20.000 lekë.
 - ✓ Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur. duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të vlerësimit- Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.
- Përsa i përket arsimit të fëmijëve përgjatë vitit 2022 kam paguar:
- ✓ Për kursim e gjuhës gjermane të djalit S.Shehaj, rreth 85.000 lekë. Ky kurs është bërë pranë qendrës Gethe Tiranë, ndërsa pagesa është bërë nëpërmjet BKT. Shuma 67.000 lekë.

- ✓ Për kursin e gjuhës angleze të djalit E. Shehaj, rreth 36.000 lekë. Ky kurs është bërë pranë qendrës Access, Tiranë. Shuma 36.000 lekë.

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues si dhe sqarime me shkrim, në lidhje me shpenzimet e deklaruara, ku sqaron se: Në lidhje me kursin e gjuhës gjermane, pranë qendrës Gethe, për djalin S. Shehaj, gjatë vitit 2022, është paguar shuma prej 64.000 lekë pa përfshirë komisionet bankare. Ndërsa në muajin janar 2023 është bërë dhe një pagesë tjetër për vijimin e kursit, kurs i cili është zhvilluar gjatë muajve shkurt - prill 2023. Në total pranë qendrës Gethe është bërë pagesa prej 82.000 lekë.

Në lidhje me kursin e gjuhës angleze për djalin E. Shehaj, b/lidhur një vërtetim i lëshuar nga Qendra Access, që vërteton pagesat e bëra nga ana e tyre pranë kësaj qendre.

B/lidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:

- Mandate pagesash nga BKT, (5 mandate), për periudhën 14.06.2022 - 31.01.2023, ku rezulton se Gentjan Shehaj, paguan për S. Shehaj, kursin e gjermanishtes, në favor të Qendrës Gethe Zentrum, në vlerën totale 82.500 lekë.
- Vërtetim nga Qendra Access, datë 12.12.2023, ku vërteton se E. Shehaj, ka kryer kursin e gjuhës Angleze, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 dhe është faturuar në vlerën 36.000 lekë.
- ✓ Në proces verbalin e datës 12.01.2024, subjekti ka sqaruar në lidhje me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve për të gjithë periudhën deri në datën e dorëzimit të deklaratës, sqaron se të dy fëmijët e tij kanë ndjekur shkollimin publik, pranë shkollës 9 vjeçare "****" Tiranë. Nga viti 2021, djali S. Shehaj vazhdon shkollën e mesme tek "****", Tiranë.
- ✓ Me e-mailin e datës 12.01.2024, subjekti ka b/lidhur dokumentacionin si më poshtë:
 - Dokumentacion (në gjuhën Angleze), nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, dëftesë e arsimit të Shkollës 9- Vjeçare "****", viti shkollor 2020 - 2021, për studentin S. Shehaj, klasa e nëntë.
 - Dokumentacion (në gjuhën Angleze), nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dëftesë e arsimit të shkollës "****" viti shkollor 2021 - 2022, për studentin S. Shehaj, klasa e dhjetë.
 - Dokumentacion (në gjuhën Angleze), nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, dëftesë e arsimit të shkollës "****" viti shkollor 2022 - 2023, për studentin S. Shehaj, klasa e njëmbëdhjetë.
- ✓ Me e-mailin e datës 15.01.2024, subjekti ka b/lidhur dokumentacionin si më poshtë:
 - Dëftesa për S. Shehaj, në shkollën 9-Vjeçare "****" Tiranë, për periudhën 2018 - 2022.
 - Dëftesë për klasën e pestë të arsimit fillor në shkollën 9-Vjeçare "****", Tiranë, për vitin shkollor 2022 - 2023.
 - Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e fëmijëve gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë rezultojnë në total rreth 118.000 lekë.

53. TË DHËNA KONFIDENCIALE

1. Të dhënat e kërkuara në këtë rubrikë janë pasqyruar të gjitha në rubrikën "Deklarimi i pasurisë dhe burimi i krijimit". Nuk kam gjë tjetër për të deklaruar përveç atyre të deklaruara në atë rubrikë. Trajtuar më lart.
2. BKT, marrëdhënie kreditimi, shuma 9.650.000 lekë, të marra nëpërmjet kontratës së kredisë lidhur në datën 16.3.2022, me nr. 1189 rep, nr. 458 kol, në prani të noteres E.M. Trajtuar më lart.

3. A.N.P, marrëdhënie kontraktuale. Shuma 9.000 euro, të njohura si investim të bëra në pronën e blerë nga ana e A.P, me nr. ***. Vërtetuar nëpërmjet deklaratës noteriale para noterit A.B, me nr. 131 rep, nr. 50 kol, datë 18.02.2022. Kjo shumë do të shlyhet në dhjetor 2023 dhe është pa interes. Trajtuar më lart.
4. A.R.Sh, babai, shuma 7.500 euro, të marra hua për të paguar këstin e parë për blerjen e pronës me nr. ***. Shuma është kaluar në llogarinë time individuale pranë BKT, në muajin shkurt 2022 dhe do të shlyhet në prill 2023 dhe është pa interes. Trajtuar më lart.

DEKLARIMI I BASHKËSHORTES - IVA SHEHAJ

54. 8. Automjet, me targë AA***XN, marka VË, Golf plus, Viti i prodhimit 2007, data e regjistrimit 14.04.2019, data e blerjes 10.04.2019, kontratë shitblerje datë 10.04.2019, nr. *** rep, nr. *** kol. Vlera e blerjes 5.000 euro. Burimi, kursime në shumën 2.500 euro. Kursime familjare nga unë dhe b/shorti im deri në momentin e blerjes së automjetit. Hua shuma 2.500 euro, marrë nga vjehri A.Sh, shumë kjo që është shlyer në muajin qershor 2020. Vlera 5.000 euro. Zotëron 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitblerje automjeti nr. *** rep, nr. *** kol, datë 10.04.2019, me palë shitëse A.M. dhe blerës Iva Shehaj, për autoveturë tip VW Golf plus, Viti 2007, në vlerën 5.000 euro, paguar jashtë zyrës noteriale.

 DPSHTRR me shkresën nr. *** prot, datë 23.08.2023, konfirmon në emër të Iva Shehaj, automjetin me targë AA***XN. B/lidhur praktika.

 Unioni Financiar Tiranë me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon në emër të Iva Shehaj, një dërgesë në vlerën 3.000 euro.

Në ILDKPKI është administruar dokumentacioni si më poshtë:

- Përgjigje e DPSHTRR, nr. *** prot, datë 09.05.2022, ku konfirmon në emër të Iva Shehaj, automjetin me targë AA***XN, blerë sipas kontratës nr. *** rep, nr. *** kol, datë 10.04.2019, me palë shitës A.M. dhe blerës Iva Shehaj, për autoveturë tip VW Golf plus, viti 2007, në vlerën 5.000 euro. B/lidhur praktika.
- Relacion shpjegues dërguar nga Gentjan Shehaj, pranë ILDKPKI, datë 21.06.2022, ku sqaron se për blerjen e këtij mjeti, i është dërguar me Western Union, në dt. 04.04.2019 shuma prej 3.000 euro shtetasit A.B. Ky shtetas, në atë kohë, ka qenë së bashku me shtetasin A.M, në Gjermani. A.M, ka qenë kontaktuar nga ana e tyre për blerjen e mjetit, por blerja e mjetit në Gjermani dhe kontrata e blerjes nga ana e tyre në Shqipëri është bërë ndërmjet bashkëshortes dhe shtetasit A.M.
- Deklaratë e thjeshtë datë 16.06.2022, nga A.B, i cili deklaron se nga datat 3 deri në mes të muajit prill 2019, ka qenë në Gjermani dhe është kontaktuar nga Iva Shehaj për të blerë një makinë, pasi punojnë të dy tek Spitali ***. Në datën 04.04.2019 Iva Shehaj i ka dërguar shumën 3.000 euro me Wester Union. Në atë periudhë ka qenë së bashku me shokun e tij në Gjermani, shtetasin A.M. Pasi gjeti një automjet tip Golf Plus, e vitit 2007, dha konfirmimin edhe Iva Shehaj. Procedurat e blerjes së automjetit i ka ndjekur shtetasi A.M. Për blerjen e automjetit, ku A.M, ja shiti Iva Shehaj, u përdor vlera 3.000 euro e paguar nga ajo, si dhe pjesën tjetër prej 2.000 euro ja ka dhënë A, kur u bë kontrata e shitblerjes.
- Deklaratë e thjeshtë datë 16.06.2022, nga A.Sh, i cili deklaron se në muajin prill 2019, i ka dhënë hua shumën 2.500 euro, shtetases Iva Shehaj, dhe se kjo shumë i është kthyer në muajin

qershor 2020. Burimi i kësaj vlere ka ardhur nga kursimet ndër vite të tij dhe të b/shortes, si dhe nga shitja e një banese në qytetin e Ballshit, në vitin 2016.

✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar, të administruar, dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse.

1. Garazh me sipërfaqe totale 23 m², blerë në vlerën 6.000 euro nga unë dhe b/shorti Gentjan Shehaj. Shuma e paguar në momentin e lidhjes së kontratës 3.000 euro, shuma tjetër 3.000 euro ju shlye ish pronarit në muajin shtator 2022. Numri i pasurisë ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, e regjistruar në ZVRPP Tiranë. Sipërfaqja takuese 11.5 m². Data e regjistrimit 21.12.2021, data e blerjes 02.12.2021, adresa, rruga “****”, nr. ***, Njësia Administrative nr. 6, Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, lidhur para noterit A.B, ndërmjet meje, b/shortit Gentjan Shehaj dhe shitësit A.P dhe M.P. Burimi, pasqyruar në deklarin e b/shortit Gentjan Shehaj. Vlera 6.000 euro. Zotëron 50%. Trajtuar më lart.
2. Garazh me sipërfaqe totale 23.7 m², blerë në vlerën 6.500 euro, nga unë dhe b/shorti Gentjan Shehaj. Shuma e paguar në momentin e lidhjes së kontratës 3.000 euro, shuma tjetër 3.500 euro ju shlye ish pronarit në muajin shtator 2022. Numri i pasurisë ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, e regjistruar në ZVRPP Tiranë. Sipërfaqja takuese 11.85 m². Data e regjistrimit 21.12.2021, data e blerjes 02.12.2021, adresa, rruga ***, nr. ***, Njësia Administrative nr. 6, Tiranë. Kontratë shitblerje nr. *** rep, nr. *** kol, datë 02.12.2021, lidhur para noterit, ndërmjet meje, b/shortit Gentjan Shehaj dhe shitësit A.P dhe M.P. Burimi, pasqyruar në deklarin e b/shortit Gentjan Shehaj. Vlera 6.500 euro. Zotëron 50 %. Trajtuar më lart.
3. Njësi biznesi me sipërfaqe totale 49.8 m², nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, data e regjistrimit 28.02.2022, data e blerjes 15.02.2022, adresa, Bulevardi “****”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë. Burimi, pasqyruar në deklarin e b/shortit Gentjan Shehaj. Vlera 63.000 euro. Zotëron 50%. Trajtuar më lart.
4. Njësi biznesi me sipërfaqe totale 52.8 m², nr. ***, zk. ***, vol. ***, fq. ***, regjistruar pranë ZVRPP Tiranë, data e regjistrimit 28.02.2022, data e blerjes 15.02.2022, adresa, Bulevardi “****”, Njësia Administrative nr. 5, Tiranë. Burimi, pasqyruar në deklarin e b/shortit Gentjan Shehaj. Vlera 33.000 euro. Zotëron 50%. Trajtuar më lart.

DEKLARIMI 1 TË ARDHURAVE

Të dhënat e kësaj rubrike janë pasqyruar në formularin e plotësuar nga b/shorti im Gentjan Shehaj. Nuk kam të ardhura të tjera veç atyre të deklaruara në formularin e b/shortit. Trajtuar më lart.

TË DHËNA KONFIDENCIALE

Të dhënat e kësaj rubrike janë pasqyruar në formularin e plotësuar nga b/shorti im Gentjan Shehaj. Nuk kam detyrime të tjera veç atyre të deklaruara në formularin e b/shortit. Trajtuar më lart.

55. Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, Gentjan Shehaj ka deklaruar adresën e plotë ku është i regjistruar në Gjendje Civile: Rruga “****”, pallati ***, shkalla ***, hyrja nr. ***, Njësia Bashkiake nr. 6, Tiranë.

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues si dhe sqarime me shkrim në lidhje me adresën e saktë të banimit, ku sqaron se adresa që pasqyrohet dhe në regjistrin e gjendjes civile, është rruga “****” pallati ***, shkalla ***, hyrja nr. ***, Njësia Bashkiake nr. 6, Tiranë. Nga ana e tij në disa raste është deklaruar se adresa e banimit është në rrugën “****”. Në lidhje me këtë paqartësi sqaron se banesa është e njëjta, pasi rruga “****” është

rrugë që kryqëzohet me rrugën “****” dhe para se këto të dhëna të pasqyroheshin në regjistrin e gjendjes civile i është referuar rrugës “****”. Me vendosjen e sistemit të numrave në pallatet e lagjes dhe pasqyrimin të tyre në regjistrin e gjendjes civile i është referuar të dhënave që pasqyrohen në këtë regjistër.

- ✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me adresën e deklaruar ku sqaron se është e njëjta me adresën e banimit ku ndodhet apartamenti i deklaruar në rrugën “****” Tiranë.

56. Përveç sa sipër në ILDKPKI është administruar dokumentacioni si më poshtë:

- Deklarata Periodik/Vjetor 2018, ku subjekti ka deklaruar: “Pagesa për specializimin e b/shortes në fushën e mjekësisë 115.000 lekë”.
- Deklarata Periodik/Vjetor 2019, ku subjekti ka deklaruar: “Shërbime shëndetësore dentare për djalin 140.000 lekë”.
- Deklarata Periodik/Vjetor 2020, ku subjekti ka deklaruar: “Shërbime shëndetësore si kurim ndaj Covid 19, në shumën 300.000 lekë për vete dhe b/shorten, si shërbime dentare”. Kryerja e disa ditëve pushime verore 60.000 lekë. Mbështetje mujore për një familje të prekur nga tërmeti në fshatin Bubq 4.000 lekë + komision poste çdo muaj në total 50.000 lekë për 12 muaj

57. Relacion shpjegues dërguar nga Gentjan Shehaj, pranë ILDKPKI, datë 21.06.2022, ku sqaron se pagesa e specializimit të bashkëshortes në fushën e mjekësisë, vërtetohet nga fotokopje e dy faturave të paguara në kohë të ndryshme. Për pjesën “Shërbime shëndetësore si kurim ndaj Covid - 19, për vete dhe bashkëshorten dhe shërbime dentare”, në vlerën 300.000 lekë janë shpenzuar në tre zëra në drejtimin shëndetësor, konkretisht: kurim ndaj Covid - 19, shërbim dentar dhe vaksina. Në lidhje me “mbështetjen mujore për një familje të prekur nga tërmeti i muajit nëntor 2019, në fshatin Bubq”, sqaron se nga të ardhurat e tij ka mbështetur përgjatë vitit 2020, një familje, në shumën simbolike 4.000 lekë në muaj. Pagesat janë bërë nëpërmjet zyrave të Postës Shqiptare dhe në total gjatë vitit 2020 ka shpenzuar 50.000 lekë. Nuk ka ruajtur fatura.

Fatura tatimore shitje (24 fatura), për periudhën 13.06.2020 - 26.11.2020, në emër të Gentjan dhe Iva Shehaj, nga Spitali ***, vlera totale 156.984 lekë.

Faturë tatimore shitje, datë 18.8.2020 nga “****”, për Iva Shehaj, vlera 10.000 lekë. Vërtetim nga “****”, datë 15.06.2022, ku vërteton se S. Shehaj ka kryer shërbime në këtë klinikë për periudhën 2019-2020, në vlerën totale 136.000 lekë. Mandat pagese nga Credins Bank dt. 04.04.2018, ku Iva Shehaj paguan vlerën 59.100 lekë me përshkrimin “****”.

Mandatpagese nga Credins Bank dt. 26.09.2018, ku Iva Shehaj paguan vlerën 56.100 lekë me përshkrimin “Spc. Lab. Biokimi V.4, Kst. 2, Iva Shehaj”

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në lidhje me shpenzimet e mësipërme, ku sqaron se ato janë raportuar në mënyrë të detajuar të shoqëruara me dokumentacion në relacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI, në datën 21.06.2022. Sa më sipër, sipas dokumentacionit të administruar rezulton se për periudhën 2018 - 2020. subjekti ka kryer shpenzime mjekësore dhe dentare të dokumentuara në total rreth 302.000 lekë dhe për specializimin e b/shortes në total rreth 115.000 lekë. Gjithashtu ka deklaruar shpenzime në formë mbështetje mujore për një familje të prekur nga tërmeti, në vlerën totale 50.000 lekë. Në mënyrë të përmblëdhur, referuar të dhënave të deklaratës së pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar deri në datë 17.02.2023, si më poshtë:

1. Apartament me sipërfaqe totale 85.70 m², adresa rruga “****”, Tiranë. Vlera 39.593 euro. Zotëron 100%

2. Garazh me sipërfaqe totale 23 m², adresa rruga "****", Tiranë. Vlera 6.000 euro. Zotëron 100%, me b/shorten.
3. Garazh me sipërfaqe totale 23.7 m², adresa rruga "****", Tiranë. Vlera 6.500 euro. Zotëron 100%, me b/shorten.
4. Njësi biznesi me sipërfaqe totale 49.8 m², adresa Bulevardi "****", Tiranë. Vlera 63.000 euro. Zotëron 100%, me b/shorten.
5. Njësi biznesi me sipërfaqe totale 52.8 m², adresa Bulevardi "****", Tiranë. Vlera 33.000 euro. Zotëron 100%, me b/shorten. Investim në dy njësitë në vlerën totale 9.000 Euro, kryer nga pala shitëse (subjekti ia ka detyrim për t'u shlyer).
6. Llogari bankare "Future", në emër të djalit tim S. Shehaj, pranë bankës Intesa Sanpaolo, çelur në datë 05.06.2006. Vlera 19.800 lekë.
7. Gjendje cash, në vlerën 645.000 lekë.
8. Kredi në BKT, marrë në datën 16.03.2022, në vlerën 9.650.000 lekë. Detyrimi 9.223.324 lekë.
9. Detyrim në vlerën 9.000 euro, sipas deklaratës dt. 18.02.2022, ndaj shtetasit A.P, pala shitëse e dy njësive në Rr. "****", Tiranë.
10. Detyrim në vlerën 7.500 euro, për blerje pasurie, ndaj shtetasit A.Sh.
11. B/shortja automjet, me targë AA****XN, marka VË, Golf plus, viti 2007. Vlera 5.000 euro. Zotëron 100%.
12. Vlera e pasurisë është rreth 20.535.107 lekë.
13. Subjekti ka detyrime financiare, kredi bankare në vlerën 9.223.324 lekë dhe huamarrje në vlerën 16.500 euro e konvertuar në total rreth 11.130.000 lekë. (Konvertuar me kursin e këmbimit të BSH, të datës 17.02.2023, ku 1 Euro 115.57 lekë).

Banka e Shqipërisë, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka Procredit, Union Bank Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing. Albania Leasing, Landeslease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, AK Invest, Easypay, Fondi BESA, Institucioni Financiar NOA, Lutecredit, Albania Kredo Financë konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarin.

Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Tirana Rurale 1, Tiranë Veri, Zonat e Stimuluara, Kurbin, Mallakastër, Shkodër, Vlorë, Kukës, Sarandë, Korçë, Lezhë, Fier, Berat, Gjirokastrë, Pogradec, Kamës-Vorë, Lushnje, Kuçovë, Malësi e Madhe, Gramsh, Kavajë, Elbasan Kolonjë, Skrapar, Durrës, Tropojë, Bulqizë, Peqin, Mirditë, Tepelenë, Përmet, Krujë, Devoll, Librazhd, Mat, Dibër nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

Raiffeisen Bank me shkresën nr. *** prot, datë 10.08.2023, konfirmon llogari page në lekë, në emër të Gentjan Shehaj, me gjendje në datën 17.02.2023, në vlerën 595 lekë.

BKT me shkresën nr. *** prot, datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje në datë 17.02.2023 në vlerën 232 lekë, Llogari kartë krediti me limit 100.000 lekë

Tirana Bank me shkresën nr. *** prot, datë 18.08.2023, konfirmon në emër të Gentjan Shehaj, Llogari depozite në lekë, ku konstatohet se në datën 27.12.2002, krijon depozitë në vlerën 70.000 lekë, në datën 27.10.2004, shton depozitën në vlerën 377.000 lekë, dhe e mbyll në vitin 2006.

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në lidhje me burimin e të ardhurave dhe destinacionin e përdorimit të ardhurave të tërhequra nga llogaria bankare pranë

Tirana Bank, ku sqaron se këto të ardhura janë kursimet e tij gjatë punës si oficer policie, përgjatë viteve 2000 - 2004. Ato janë tërhequr nga ana e tij dhe deklaroi se këto të ardhura dhe të ardhura të tjera që kanë kursyer si familje, pas vitit 2004 deri në vitin 2007, janë përdorur për të bërë pagesën e këstit të parë prej 7.000 Euro, në datën 17.11.2007, për blerjen e apartamentit ku banon aktualisht. Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me përdorimin e depozitës bankare në Tirana Bank pas tërheqjes së saj në v. 2006, për blerjen e apartamentit në Tiranë.

✚ ABI Bank me shkresën nr. *** prot, datë 15.08.2023, konfirmon në emër të E. Shehaj Llogari për fëmijë, në të cilën ka kaluar shpërblim nga Bashkia, në vlerën 5.000 lekë.

✚ Credins Bank me shkresën nr. 55/10 prot, datë 02.10.2023, konfirmon në emër të Iva Shehaj, llogari në euro, për periudhën 21.08 2019 - 31.12.2019. Llogaria rezulton e mbyllur. Konfirmon në emër të S. Shehaj, llogari për fëmijë në lekë, ku ka përfituar kreditime si nxënës me rezultate, dhënie stimuli, nga Bashkia Tiranë, për periudhën 2017 - 2022, në vlerën totale 153.000 lekë. Gjendja e Llogarisë në datë 17.02.2023, në vlerën 0 lekë. Konfirmon në emër të E. Shehaj, Llogari për Fëmijë në lekë, ku konfirmohet kreditim nga Njësia Bashkiake nr. 9, pagesat e Fëmijëve, në datë 02.04.2015, në vlerën 5.000 lekë. Gjendja e Llogarisë në datë 17.02.2023, në vlerën 2.810 lekë.

✚ DPT me shkresën nr. V-prot, datë 21.8.2023, konfirmon të regjistruar shtetasit: Gentjan Shehaj, me Nipt. K31522***I, DRT Tiranë, Administrator, viti 2002. A.Sh, me Nipt. K53517***P, DRT Fier, viti 2005.

Me inventarin e datës 13.12.2023 subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim në lidhje me dy numrat e Nipti të konfirmuara në Tiranë dhe Fier, si më sipër, ku sqaroi se në të dy rastet këto konfirmime nuk i përkasin subjektit dhe as babait të tij.

✓ Subjekti ka dhënë sqarime në lidhje me konstatimet e DPT, si më sipër, se këto subjekte tregtare nuk i përkasin subjektit dhe babait të tij A.Sh.

✚ DRT Fier me shkresën nr. V-prot, datë 29.08.2023, nuk konfirmon të regjistruar biznes pranë kësaj drejtorie, në emër të subjektit apo personave të lidhur. Konfirmon të regjistruar shtetasin A.Q.Sh. me Nipt. K53517***P, i cili nuk përputhet me të dhënat e shkresës.

✚ ISSH. Drejtoria Juridike, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, i dërgon shkresë Drejtorisë së Arkivit Qendror Lundër, për të ardhurat e personave të përmendur në shkresë, për periudhën para vitit 2012.

✚ Drejtorja e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. *** prot, datë 11.08.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit apo personave të lidhur.

Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruar dhe pamjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruar, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesave, u bë analiza e të dhënave të deklaruar nga subjekti me informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, proces nga i cili, në mënyrë të përmbledhur, rezultoi se;

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, pasuria totale deri në datë 17.02.2023, është deklaruar është bruto 664.800 lekë + 162.093 euro e konvertuar rreth 19.398.000 lekë dhe neto rreth 8.268.000 lekë.

✓ Të ardhurat e subjektit nga pagat, shpërblimet, dietat, për periudhën tetor 2000 - shkurt 2023, në vlerën totale rreth 20.166.000 lekë.

✓ Të ardhurat nga qiraja e njësisë me nr. ***, ndodhur në Tiranë, për periudhën mars 2022 - shkurt 2023, në vlerën totale 276.000 lekë.

- ✓ Të ardhurat e b/shortes nga paga, honorarë dhe shpërblime, për periudhën shtator 2005 - shkurt 2022, në vlerën totale rreth 12.247.000 lekë + 24.185 euro konvertuar rreth 15.042.000 lekë.
- ✓ Fitimi neto nga aktiviteti si person fizik i b/shortes, për vitin 2022, në vlerën 2.042.000 lekë.

58. Gjithashtu si burim ka deklaruar;

- o Huamarrje në v. 2016, nga vjehtëri R.D. në vlerën 7.000 euro dhe V.P. në vlerën 2.000 euro, të shlyera në v. 2017.
- o Kredi bankare në ABI Bank (Emporiki Bank), në vlerën 26.000 euro në v. 2007, shlyer në v. 2016.
- o Huamarrje nga babai A.Sh në v. 2022, në vlerën 7.500 euro, shlyer në v.2023.
- o Dhurim nga babai në vlerën totale 310.000 lekë, për periudhën 2007 - 2009 dhe v.2012.
- o Kredi bankare në BKT, në v. 2022, në vlerën 9.650.000 lekë. Detyrimi në vlerën 9.223.324 lekë.
- ✓ Për periudhën tetor 2000 - mars 2023, referuar treguesve statistikorë të INSTAT, janë shpenzuar minimalisht për konsum familjar, rreth 13.798.752 lekë.
- ✓ Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 janë shpenzuar për ujë, drita, telefon dhe internet etj., në total rreth 135.000 lekë.
- ✓ Për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022 janë shpenzuar për udhëtimet private, personale jashtë territorit shqiptar, në total rreth 175 euro, konvertuar rreth 20.000 lekë.
- ✓ Për periudhën deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, janë shpenzuar për arsimimin e fëmijëve, në total rreth 118.000 lekë.
- ✓ Për arredimin dhe punime të apartamentit, sipas deklarimit të subjektit, janë shpenzuar në total rreth 1.917.000 lekë.
- ✓ Për qira banese, sipas deklarimit të subjektit, gjatë periudhës 2004 - 2008, janë shpenzuar në total rreth 820.000 lekë.
- ✓ Shpenzime mjekësore dhe dentare, gjatë periudhës 2019 - 2020, në total rreth 302.000 lekë
- ✓ Shpenzime për specializimin e b/shortes, gjatë vitit 2018, në totale rreth 115.000 lekë.
- ✓ Shpenzime në formë mbështetje mujore për një familje të prekur nga tërmeti, gjatë vitit 2020, në total rreth 50.000 lekë.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e vlerësimit, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 12/2018 i ndryshuar, në vlerësimin përfundimtar, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit si dhe ato në seancën dëgjimore dhe në përfundim arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit z. Gentjan Shehaj:

- ✓ Ka bërë deklarim të saktë, në përputhje me ligjin, me burime të ligjshme financiare;
- ✓ Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ✓ Nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- ✓ Nuk është kryer deklarim i rremë;
- ✓ Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit;

B. KONTROLLI I FIGURËS

59. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
60. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre element:
1. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 2. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;
 3. Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, germa (ë), e ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
61. Trupa e Vlerësimit ka kryer kontrollin e figurës të subjektit të vlerësimit Z. Gentjan Shehaj, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, verifikimin e vërtetësisë dhe të besueshmërisë të deklarimeve si dhe të identifikohet nëse subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në veprimtari kriminale, sipas kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar.
62. Për kontrollin e figurës Trupa e vlerësimit administroi:
- a) Deklaratën e Kontrollit të Figurës.
 - b) Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
63. Struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit Z. Gentjan Shehaj , me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim të identifikojë nëse subjekti i vlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në ligjin nr. 12/2018 të ndryshuar, ka dërguar raportin përfundimtar me shkresën nr. *** prot., datë 22.12.2023, për subjektin e vlerësimit, në përputhje me nenin 42, pika 2, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, dhe konstaton se:
- ✓ *Formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit Nr. 12/2018, i ndryshuar,*
 - ✓ *Për subjektin e vlerësimit Z. Gentjan Agron Shehaj, me detyrë me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, në Akademinë e Policisë, dhe "personave të lidhur", nuk administrohen të dhëna, fakte apo prova, që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, apo që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

Në deklaratën e Kontrollit të Figurës shtojca 1 subjekti ka deklaruar se:

 Gjeneralitetet

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve,
- Nuk është njohur nga të tjerë me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër,
- Nuk ka pasur nënshtetësi tjetër,

 Në deklaratën për kontrollin e figurës, pjesa e 2-të, shtojca 1, subjekti deklaron të dhënat përkatëse mbi vendbanimin,

🚩 Në pjesën 3 dhe 4, të shtojcës 1, subjekti ka deklaruar të dhëna ndër vite lidhur me arsimin, kualifikimet, specializimet apo trajnimet dhe punësimin përkatës,

🚩 Në pjesën 5, të shtojcës 1, lidhur me të dhënat e sigurisë subjekti ka deklaruar:

- Nuk është dënua ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj,
- Nuk ka qenë në hetim dhe gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- Nuk ka qenë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo.
- Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- Nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij bashkëshorti/bashkëshortja, fëmijët, bashkëjetuesi/t si dhe personat e përfshirë në certifikatën familjare) është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit sipas përcaktimeve të ligjit për integritetin e personave që zgjidhen emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe të një natyre sigurie të veçantë apo gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie apo të ketë nëpërkëmbur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish- shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike
- Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

Po ashtu, subjekti ka nënshkruar edhe dy vetëdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

❖ **Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit e AMP:**

64. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektin e vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet e duhura nga struktura përgjegjëse pranë AMP duke kërkuar të dhëna nga institucionet të shprehura në këtë ligj.
65. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, Trupa e vlerësimit konstatoi se:
- **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot, datë 07.08.2023 konfirmon se: *Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Gentjan Agron Shehaj.*
 - **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot, datë 28.07.2023 konfirmon se : *Nuk rezulton i dënuar.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “Sekret” nr. *** prot, datë 08.08.2023 bën me dije se: *Pas verifikimeve të kryera për Z. Gentjan Agron Shehaj, nuk ka të dhëna në lidhje me cenimin e sigurisë kombëtare, apo aktivitet të kundërligjshëm.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot, datë 11.08.2023 konfirmon se:
 - a) *Nuk ka dhëna apo indice për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta.*
 - b) *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar") ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj.*
 - c) *Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", i ndryshuar.*
 - d) *Nuk ka të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale.*
 - e) *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale.*
 - f) *Nuk ka të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhër ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale.*
 - g) *Nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj.*
 - h) *Nuk ka të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS.*
 - i) *Nuk ka të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.*
 - j) *Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.*
 - **Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes** me shkresën “Konfidencial” nr. *** prot, datë 04.08.2023 konfirmon se: *Nuk disponon të dhëna.*
 - **Nga një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “Sekret” datë 03.08.2023 dhe shkresën “Sekret” nr. *** prot, datë 03.10.2023 si edhe me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot datë 16.08.2023 bën me dije se:
 - o *Nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm.*
 - o *Nuk ka procedime penale të referuara.*

- *Nuk disponohen ankesa , të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.*
 - **Organi ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot, datë 27.09.2023, si edhe me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot., datë 29.05.2024 konfirmon se:
 - *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
 - *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata*
 - *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të K.P.P.*
 - *Nuk ka patur regjistrim të njoftimit të veprave penale.*
 - *Nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit.*
 - Nga një institucion tjetër ligjzbatues me shkresën “I kufizuar” nr. *** prot, datë 11.08.2023 bën me dije se:
 - *Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi.*
 - *Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal.*
 - *Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35, të kodit të Procedurës Penale.*
 - *Nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit.*
 - Nga një institucion ligjzbatues me shkresën “Sekret” nr.*** prot, datë 04.08.2023 konfirmon se:
 - *Nuk rezulton raportime financiare përveç atyre rutinë.*
 - **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar** me shkresën “I kufizuar, nr. *** prot, datë 31.07.2023 konfirmon se :
 - *Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP) në nivelin “Tepër Sekret”, lëshuar më datë 02.08.2018 deri më 01.08.2023*
 - *Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.*
 - *AKSIK nuk disponon rekorde sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.*
 - **Një institucion tjetër ligjzbatues** me shkresën “I kufizuar” nr.*** datë 07.05.2024 konfirmon se:
 - *Nuk rezulton që në emër të shtetasve të mëposhtëm të jetë regjistruar ndonjë procedim penal*
 - **Avokati i Popullit** me shkresën “E paklasifikuar” nr. *** prot, datë 14.08.2023 konfirmon se:
 - *Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime ose mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.*
 - *Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti*
 - **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit** me shkresën “I kufizuar” nr.*** datë 24.11.2023 bën me dije se:
 - *Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i shtetit deri me 02 Korrik1991.*
66. Pranë Trupës Vlerësuese, nuk janë paraqitur denoncime nga publiku ndaj subjektit të vlerësimit Gentjan Shehaj, për shkelje të rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, sipas parashikimit ligjor të nenin 36 pika “ë” të ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar).
67. Testi për përdorim lëndësh narkotike: Subjekti i vlerësimit z. Gentjan Shehaj në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, me shkresën nr. *** prot., nr.*** regj., datë 15.05.2024 të Institutit Mjekësisë Ligjore protokolluar me tonën nr. *** datë 20.05.2024, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara të testimit për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se:

- Në mostrën e urinës marrë subjektit me kod shifror ***, mbyllur në kontejner, nuk u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të MOP (opiate/heroine), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (tricklike antidepresante), AMP (amfetamine), MDMA (ekstazi), BZO (benzodiazepina), MET (metamphetamina).

68. Trupa e Vlerësimit pranë AMP pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit z. Gentjan A. Shehaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit nr.12/2018, të ndryshuar, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit, analizimit dhe verifikimit të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, si dhe raportin e sjellë nga struktura përgjegjëse e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Gentjan Shehaj:

- ✓ Ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi;
- ✓ Nuk ka informacion në deklarimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

69. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45, 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të “Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore”.

70. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- b. Raportin e përgatitur nga struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore/standardet profesionale në Policinë e Shtetit/Gardën e Republikës/Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Subjekti i vlerësimit Z. Gentjan Shehaj në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin “Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave edhe Koordinimit, dhe Sigurimit të Cilësisë , në Akademinë e Policisë”.

71. Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të vlerësimit mbështetet në informacionin dhe dokumentacionin e marrë nga DPPSH, në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ kryesisht si dhe nga burime të tjera të ligjshme për nivelin e arsimimit në përputhje me pozicionin e punës. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit, është kryer në përputhje me kreun V, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të Ligjit nr. 12/2018, (i ndryshuar), bazuar në nenet 43 - 46 të po këtij ligji.

72. Vlerësimi i Aftësive Profesionale nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për subjektin e vlerësimit Z. Gentjan Shehaj , bazuar në nenin 47, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar me shkresën nr.

*** prot., datë 11.08.2023 protokolluar me tonën nr. ** prot. datë 14.08.2023 arrin në përfundim se: *Punonjësi i policisë Z. Gentjan Agron Shehaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar funksionin që mban.*

73. Gentjan Shehaj është subjekt i vlerësimit të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe aktualisht mban detyrën Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave edhe Kordinimit, dhe Sigurimit të Cilësisë, në Akademinë e Policisë”, bazuar në Urdhrin e emërimit, nr. ***, datë 09.12.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
74. Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale sipas përcaktimit të nenit 43, të këtij ligji, ka të bëjë me vlerësimin e nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, respektimin e rregullave të etikës, si dhe përmbushjes së detyrave nga subjekti në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e Policisë së Shtetit.
75. Procedura për vlerësimin e aftësive profesionale kryhet bazuar në nenet 44 - 46, duke mbajtur në vëmendje aftësitë profesionale dhe ecurinë në karrierë të punonjësit duke respektuar legjislacionin e posaçëm që rregullon marrëdhënien e punës (në këtë rast ligji për Policinë e Shtetit, Rregullorja e Policisë dhe aktet e tjera rregullatorë e nënligjore në fuqi) si dhe në përshkrimet e punës për çdo funksionin. Trupa e Vlerësimit përdor si burime për vlerësimin e saj, fillimisht:
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;
 - Më tej të dhënat nga institucionet përgjegjëse që konfirmojnë nivelin arsimor dhe kualifikimet përkatëse, ecurinë në karrierë të subjektit nga dosja e personelit, vërtetime e akte të tjera administrative të emërimeve në funksionin dhe dhënies së gradave respektive, ecurinë disiplinore, vendimet e formës së prerë të gjykatave që lidhen me procese disiplinore etj. Vlerësimet e punës individuale në pesë vitet e fundit. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe shqyrton edhe denoncimet nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë jo etike.
 - Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:
- Subjekti i vlerësimit Gentjan Shehaj ka dorëzuar në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, (Formularin e Vetëvlerësimit të Aftësive Profesionale), sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit Nr. 12/2018, të ndryshuar. Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet.
76. Subjekti në kohën e depozitimit të formularit, mbante detyrën e Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave edhe Kordinimit, dhe Sigurimit të Cilësisë, në Akademinë e Policisë, funksion që e mban që prej datës 13.12.2022.

VLERËSIMI I NIVELIT ARSIMOR

77. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punë, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2/a, e ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar. Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të Subjektit, rezulton se subjekti ka përfunduar arsimin e lartë.
78. Në formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar subjekti ka deklaruar:
- ✓ Kurs 1-vjeçar i Policisë në Akademinë e Policisë nga data 01.10.1996 deri më 10.06.1997

- ✓ Akademia e Policisë cikli mësimor 1997 - 2000. Diplomë nr. *** nr. regjistrimit ***, datë 30.07.2000.
 - ✓ Universiteti “Wisdom University”, Diplomë “Bachelor” në Drejtësi, Nr. ***, regjistrimit Nr. Matrikullimit 010***, Datë 25.09.2013.
 - ✓ Universiteti i Tiranës Fakulteti i Drejtësisë, Diplomë Master Profesional në Drejtë Penale Nr. Diplomës ***, Nr. Matrikullimit UT380H020*** datë lëshimi 20.06.2019.
 - Të dhënat janë të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit me nr. 18***.
 - Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS me numër RMIS 9001***.
 - Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në Formularin e Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar.
 - Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e Subjektit.
 - Të dhënat e siguruara nga burimet e mësipërme, konfirmojnë nivelin arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet dhe vlerësimet individuale të punës si edhe performancën e konstatuar gjatë kontrolleve dhe inspeksioneve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucionet e tjera mbikëqyrëse.
79. Në kuptim të ligjit Nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar punonjësi/subjekti rezulton se subjekti, përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

❖ **Arsyetimi ligjor i Trupës Vlerësuese:**

80. Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit dhe në ligjin në fuqi Nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, trupa e vlerësimit arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, që në kohën e emërimit në detyrë për herë të parë në Policinë e Shtetit dhe deri në vijueshmërinë e ecursë në karrierë të tij, ka qenë në përmbushje të kriterit të nivelit arsimor.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit të vlerësimit, rezulton se subjekti ka kryer edhe trajnime dhe specializime dhe për këtë ka marrë edhe certifikatat përkatëse. Ai u ka kushtuar rëndësi trajnimeve që kanë të bëjnë me objektin e tij të punës si dhe ka marrë pjesë në konferenca dhe Workshop-e të ndryshëm.

Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, rezulton se ai ka kryer trajnimet/specializimet si më poshtë:

Nr.	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji dokumentit
	2000	Specialitetet e Vendit të ngjarjes, ICITAP	Certifikatë
	2002	Lufta Kundër trafikimit të qenieve njerëzore & Dhunës Gjinore	Certifikatë
	2004	Procedurat për Sigurimin e personelit dhe Standardeve minimum të "NATOS"	Certifikatë
	2004	Përgatitja e aftësive profesionale, ICITAP	
1.	2004	Trajnim 8-javor gjuhë Angleze, organizuar nga Ilea Budapest, Hungari	Certifikatë
2.	2004	Kurs Trajnimi 8-javor ILEA, organizuar në Budapest, Hungari	Certifikatë
3.	2005	Përgjegjësitë dhe Etika e Drejtimit, POINTMAN	Certifikatë
4.	2007	Kurs për Oficeret e Larte, PAMECA	Diplomë
5.	2008	Formimi i Instruktoleve	Certifikatë

6.	2009	Kurs për instruktoreset e avancuar, organizuar nga ICITÁP	Certifikatë
7.	2010	Trajnim për vlerësimin e performancës së instruktoreset, PAMECA III	Certifikatë
8.	2011	Gjuhë Angleze	Certifikatë
9.	2012	MiS.et policore konceptet, objektivat dhe eksperiencat, Gimborn Gjermani	Certifikatë
10.	2017	Hetimi i Krimeve të Lehta	Certifikatë
11.	2022	Standardet evropiane të kërkimeve shkencore dhe botimeve të tyre	Certifikatë

❖ **VLERËSIMET E PUNËS:**

81. Në dosjen personale të subjektit, për periudhën 2018-2023 rezulton së janë të administruara 4 (katër) vlerësime të aftësive individuale të punës një mungon, në të cilat është vlerësuar si vijon:

- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2018 nuk është administruar në dosje
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2019 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2020 27 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 28 Pikë (shumë mirë)
- Vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2022 94 Pikë (shumë mirë)

Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

❖ **Konkluzion i Trupës Vlerësuese:**

82. Bazuar në vlerësimet e mësipërme të punës Trupa e Vlerësimit arrin në konkluzion se subjekti i vlerësimit ka përmbushur detyrat profesionale, respektuar rregullat e etikës si edhe ka shfaqur performancë të lartë në kryerjen e detyrave profesionale.

83. Nga verifikimi në dosjen personale si dhe sistemin RMIS, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018-2023) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit, nuk është ndëshkuar disiplinarisht me masë disiplinore. Për sa analizuam rezulton se deklarimi i subjekti është i saktë.

❖ **ECURIA NË KARRIERË:**

84. Subjekti Gentjan A.Sh ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 22 vitesh e 10 muaj. Nga verifikimi në dosjen personale rezulton se gjatë periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Gentjan Agron Shehaj, ka ecurinë në karriere si vijon:

- ✓ 28.04.2017 deri më 09.03.2019 Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë,
- ✓ 09.03.2019 deri më 13.12.2022 Drejtor, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit,
- ✓ 13.12.2022 e në vazhdim Drejtor, në Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë.

85. **ECURIA NË GRADË:**

a. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Nr. ***, datë 18.06.2008 “Për dhënien e Gradës Policore një punonjësi policie” K/Inspektor Gentjan Shehaj me detyrë Specialist (Adjutant), në Zyrën ndihmëse të Drejtorit të Përgjithshëm, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë,

në zbatim të nenit 20, pika 2, neni 42, pika 2, germa “b” nenet 126 dhe 127, të ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” i jepet Grada policore “K/Komisar”.

- b. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. ***, datë 14.11.2012 “Për ngritjen në Gradë të një punonjësi policie”, bazuar në nenin 42, pika 1 dhe 2, shkronja “b”, e ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit” neni 50, pika 3 e Rregullores së Personalit të Policisë së Shtetit, K/Komisar Gentjan Shehaj, me detyrë Zëvendësdyrëtor për Sigurinë Publike ai dhe Shef Sektori i Rendit Publik, në Drejtorinë e Policisë Qarkut Dibër, shpallur fitues në konkurrimin për gradën policore “Drejtues”, përfunduar kursin e barasvlershëm/ekuivalent me shkollimin për nivelin e mesëm drejtues, i jepet grada policore “Drejtues”.
- c. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. ***, datë 29.01.2018 “Për dhënien e Gradës Policore një punonjësi policie” Drejtues, Gentjan Shehaj, me detyrë Drejtor në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë përfunduar me sukses programin e trajnimit për fitimin e gradës “Drejtues i Parë”, i jepet grada policore “Drejtues i Parë”

HETIMI I KRYER NGA TRUPA VLERËSUESE:

86. Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të Z. Gentjan A. Shehaj arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjorë në fuqi.

- ✓ Trupa e Vlerësimit konstaton se, kalimi nga grada “K/Inspektor” në gradën policore “K/Komisar” është dhënë në përputhje të plotë të ligjin.
- ✓ Trupa e Vlerësimit konstaton se, kalimi nga grada “K/Komisar” në gradën policore “Drejtues” është dhënë në përputhje të plotë të ligjin.
- ✓ Trupa e Vlerësimit konstaton se, kalimi nga grada “Drejtues” në gradën policore “Drejtues i Parë” është dhënë në përputhje të plotë të ligjin.

Trupa e Vlerësimit konstaton se, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të Z. Gentjan Shehaj arrijmë në konkluzionin se funksionet në të cilat është emëruar subjekti si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, rezultojnë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Në përfundim të hetimit të kryer:

87. Trupa e Vlerësimit pranë A.M.P ka kryer një hetim të thelluar të kontrollit të aftësive profesionale për subjektin e vlerësimit Gentjan Shehaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e Aftësive Profesionale, analizimin dhe verifikimin e të dhënave të mbledhura konkludon se:

Subjekti i Vlerësimit Z. Gentjan Shehaj është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

Në përfundim të hetimit të kryer:

Trupa e Vlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit si dhe verifikimin mbi përmbushjen e detyrave funksionale, arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit Z. Gentjan Shehaj:

- ✓ Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;
- ✓ Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;
- ✓ Ka vlerësime pozitive pune.

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e AMP, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike datë 04.07.2024, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit z. Gentjan Shehaj në përputhje me nenin 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit e AMP, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të germës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar:

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. **Gentjan Agron Shehaj**, me funksion Drejtor në Drejtorinë e Kurrikulave edhe Koordinimit dhe Sigurimit të Cilësisë, në Akademinë e Policisë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve, nga data e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë **11.07.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Kryesuese

Suela Bulku

Relator
Arben Sefaj

Anëtare
Denisa Sina

	Pasqyra e Analizes Financiare Gentjan Shehaj																	
Burimi/Viti	2000 -2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI
Të ardhura neto nga paga apo shperblime nga marredheniet e punesimit subjekti	1,267,890	711,757	977,127	918,255	472,299	811,315	979,219	1,138,351	1,132,450	1,354,896	1,390,976	1,413,476	1,099,350	1,186,477	1,126,891	1,132,757		17,113,486
Të ardhura neto nga paga Bashkeshortij	781,802	480,608	885,652	649,169	590,726	471,522	880,076	887,070	408,323	1,723,715	580,109	1,728,335	1,532,814	1,613,000	1,964,000	2,286,865		17,463,786
Të ardhura neto nga Qerate		90,000	90,000													299,000		479,000
Të ardhura nga Dhurim						130,000				200,000								330,000
Të ardhura marre kredi	3,143,660															9,650,000		12,793,660
Të ardhura nga huamarrja										1,217,430								1,217,430
Te ardhura te krijuara nga bursa e femijeve										21,857	21,857	21,857	21,857	21,857	21,857	21,858		153,000
Të ardhura të pa permendura më lart																		
Totali i të Ardhurave neto	5,193,352	1,282,365	1,952,779	1,567,424	1,063,025	1,412,837	1,859,295	2,025,421	1,540,773	4,517,898	1,992,942	3,163,668	2,654,021	2,821,334	3,112,748	13,390,480	-	49,550,362
Detyrime: Te hyra nga huate/kredi, dhurim																		-
Shpenzime jetike sipas INSTAT	707,184	409,860	639,756	639,756	853,008	558,192	558,192	944,568	953,484	982,740	970,500	1,028,868	1,107,192	1,118,700	1,138,608	1,188,144		13,798,752
Shpenzime per Qera						156,000												156,000
Shpenzime për arrendim		300,000									200,000	1,025,000	210,756	182,000				1,917,756
Shpenzime për Kurim												115,000	140,000	300,000				555,000
Shpenzime Arsimim																188,000		188,000
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit																32,268		32,268
Shpenzime uje, drita, Telefon 2022																135,000		135,000
Pagese kesti kredie			361,996	366,458	367,186	367,186	367,186	367,186	367,186	1,978,053						667,170		5,209,607
Dhurime														50,000				50,000
Shpenzime dhe te dala te tjera, shlyerje kredie										2,042,577								2,042,577
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	707,184	709,860	1,001,752	1,006,214	1,220,194	1,081,378	925,378	1,311,754	1,320,670	5,003,370	1,170,500	2,168,868	1,457,948	1,650,700	1,138,608	2,210,582	-	24,084,960
Investime,pasuri apartament, 2 garazhe	4,787,189														741,180	802,945		6,331,314
Blerje automjeti													610,850					610,850
Investime,pasuri njesi sherbimi																11,033,280		11,033,280
Gjendje llogari djali																18,318		18,318
Detyrime ndaj te treteve																1,896,345		1,896,345
Gjendje Cash																645,000		645,000
Totali Pasuri	4,787,189	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	610,850	-	741,180	14,395,888	-	20,535,107
Mundesia per Kursime : Te Ardhura+Detyrime-Shpenzime-Pasuri.	- 301,021	271,484	1,222,511	1,783,721	1,626,552	1,958,011	2,891,928	3,605,595	3,825,698	3,340,226	4,162,668	5,157,468	5,742,691	6,913,325	8,146,285	4,930,295		4,930,295